

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5865
E premte, 30 gusht 2019
çmimi 0.40 €

Kosnetti viziton KQZ-në,
njoftohet për përgatitjen
e zgjedhjeve



FAQE 4-5

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ZAFIR BERISHA

Koalicioni Nisma - AKR do të jetë befasia e zgjedhjeve

Anëtari i Kryesisë së Nismës Socialdemokrate, Zafir Berisha, është shprehur i bindur se koalicioni Nisma - AKR do të jetë befasia e këndshme e zgjedhjeve të 6 tetorit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky koalicion është mirëpritur nga elektorati dhe ka mobilizuar strukturat partiake. Sipas Berishës, edhe më të pranueshëm këtë koalicion për qytetarët e ka bërë kandidatura e Fatmir Limajt për kryeministër. Ish-deputeti i Nismës ka bërë me dije se nuk do të ketë qeveri të re pa këtë subjekt politik




OPINION

DEKORIMI I URREJTËSIT RACIST

F. 13

Rexhep QOSJA



AKTUALE

VETËM 4.7 PËR QIND E SERBËVE NË VERI I BESOJNË POLICISË SË KOSOVËS

F. 7

NGA 1 DERI MË 30 SHTATOR FILLON PERIUDHA E APLIKIMIT PËR ÇMIME TË BARNAVE

F. 7

PROTESTOJNË KOMPANITË E FUNERALEVE, AKUZOJNË BIK-un PËR MONOPOL

F. 10

EKONOMI



KRU PRISHTINA PARALAJMËRON SHKYÇJE TË BORXHILINJVE NGA 2 SHTATORI

F. 9

ATK-së I SHTOHEN 20 INSPEKTORË TË RINJ

F. 9

SPORT

DUKAGJINI DHE DRITA KËRCËNOJNË NJËRA-TJETRËN ME HUMBJE

F. 16

KRASNIQI: JAM I ZHËNJYER QË NUK DOLA I TRETË NË 'PATRA 2019'

F. 17



DnV-ja kërkon nga subjektet politike barazi gjinore në listat për deputetë

Drejtuuesi i koalicionit të OJQ-ve për vëzhgimin e zgjedhjeve "Demokracia në Veprim (DnV)", njëherësh drejtor i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, u ka bërë thirrje subjekteve politike që të garantojnë barazi gjinore në listat zgjedhore. Ai ka thënë

se pjesëmarrja e barabartë e grave në politikë është ndër elementet kyçe të demokracisë e cila mundëson zhvillim të shoqërisë. Sipas Kryeziut, garantimi i barazisë gjinore në listat për deputetë kontribuon për një qeverisje më të mirë dhe demokratike

FAQE 3

A do të fillojë me kohë viti i ri shkollor?

FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Debate të forta në PS, përplasje mes Ramës e Bushatit



Në mbledhjen e Partisë Socialiste pati debate të forta mes kryetarit dhe kryeministrit Edi Rama dhe anëtarit të kryesisë dhe ish-ministrit të Jashtëm Ditmir Bushati, për shkak të situatës së krijuar në Shkodër veçanërisht pas zbulimit të fakteve se kandidati socialist i votuar për drejtimin e Bashkisë, Valdrin Pjetri

Tiranë, 29 gusht - Mbledhja e Kryesisë së Partisë Socialiste mbrëmjen e së mërkurës është shoqëruar me debate të forta mes kryetarit dhe kryeministrit Edi Rama dhe anëtarit të kryesisë dhe ish-ministrit të Jashtëm Ditmir Bushati. Shkak është bërë situata e krijuar në Shkodër veçanërisht pas zbulimit të fakteve se kandidati socialist i votuar për drejtimin e Bashkisë, Valdrin Pjetri, rezultoi t'i kishte fshehur problemet e së kaluarës së tij, kur në fillim të viteve 2000 ishte arrestuar dhe dënuar në Itali.

Bushati ka qenë që prej vitit 2016, drejtues politik i Partisë Socialiste në Shkodër, por ai u

zëvendësua, me një vendim të Ramës, pikërisht nga Pjetri, pak përpara se ky i fundit të detyrohej të jepte dorëheqjen, pas publikimit nga opozita të dokumenteve që vërtetonin dënimin e tij në Itali. Rastin e tij, kryeministri e trajtoi si një përgjegjësi individuale, por në të kundërt, për ish-ministrin Bushati "kemi mbërritur në pikën e derdhjes për një fenomen të cilin duhet ta trajtojmë në mënyrën me agresive të mundshme. Sepse 30 vjet pas shembjes së komunizmit besoj fuqimisht që PS-ja dhe të gjithë faktorët e tjerë politike kanë mundësi t'u ofrojnë qytetarëve të zakonshëm të këtij vendi njerëzit më të mirë".

Kryesia e Partisë Socialiste, siç njoftoi sekretari i saj i përgjithshëm Taulant Balla, ka vendosur "riformatimin" e degës së saj në Shkodër, ose e thënë ndryshe shkriren e strukturave aktuale, ndërsa kryeministri Rama ka kërkuar dorëheqjen e të gjithë drejtuesve të institucioneve lokale atje, të paktën të atyre të gjinisë mashkullore. Balla njoftoi gjithashtu për synimin e PS-së, të paralajmëruar dhe nga Rama, për t'i ashpërsuar ndëshkimet e parashikuara nga i ashtuquajtur Ligj për dekriminalizimin. Por për Bushatin "kjo nuk është një çështje që mund të trajtohet thjesht dhe vetëm në mënyrë ligjore e procedurale. As me zhvendosje vëmendje me shkarkime në masë të njerëzve që s'kanë asnjë lidhje dhe asnjë fajësi për situatën e krijuar". Ish-ministri i Jashtëm ishte i drejtpërdrejtë kur u shpreh se "në rast se përgjegjësia për të kaluarën e secilit është një përgjegjësi individuale dhe ligjore, ne na takon

që të njohim realitetin dhe përgjegjësinë politike, të themi edhe na falni për rastin në fjalë". E duke folur për një fenomen, Bushati i mëshoi fort idesë se ne kemi përgjegjësinë e madhe për ta trajtuar këtë fenomen dhe për ta shfarosur atë. "Gabimet që kemi bërë në të shkuarën kur njerëz me të kaluar të dyshimtë, i përjashtuam nga radhët tona, u përshëndetëm publikisht nga ShBA-ja, fatkeqësisht u rikthyen në tryezat tona vendimarrëse. Dhe sot na duhet të administrojmë pasojat e këtyre gabimeve. E

për këtë arsye, sipas ish-ministrit të Jashtëm "si politikanë, kemi përgjegjësinë për të hapur një debat dhe për të trajtuar rrënjët e këtij fenomeni dhe jo thjesht për t'i menaxhuar pasojat. Rrënjët e këtij fenomeni mendoj se kanë lidhje me nevojën për një reformë politike brenda partive tona. Një reformë politike që të sjellë një kulturë të re politike, një sistem të ri llogaridhënës ku PS është dhe duhet të jetë partia e intelektit, progresit dhe pse jo partia e komuniteteve", tha Bushati. (voa).



Bill Clintoni i shkruan letër falënderuese Kadri Veselit

PRISHTINË, 29 GUSHT - Ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Bill Clinton, i ka dërguar letër kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli përmes së cilës e ka falënderuar për pritjen e organizuar në Kosovë me rastin e 20-vjetorit të çlirimit të vendit tonë.

"Dua t'ju falënderoj për pritjen e ngrohtë në Prishtinë në qershor.

Ishte nder për mua të shënoj dy dekada të paqes bashkë me qytetarët dhe të përkushtohemi për një të ardhme të shanseve të barabarta. Mbajeni në mend se ju dëshiroj gjithmonë suksese", ka shkruar ndër të tjera Clintoni. Letër falënderuese dhe mbështetëse Veselit i ka dërguar edhe ish-sekretarja Madeleine Albright.

Amendamenti i kontratës koncesionare, mundësi për ta ndryshuar taksën në rrugën Durrës-Kukës

TIRANË, 29 GUSHT - Mediet kanë raportuar se Qeveria e Kosovës është e shqetësuar për një taksë të re që mund të vendoset mbi makinat e tonazhit të rëndë në rrugën Durrës-Kukës. Sipas ankesës së palës së Kosovës duke filluar nga data 1 shtator në Rrugën e Kombit do të instalohen peshoret, çka mund të sjellë taksë shtesë për makinat e tonazhit të rëndë.

Mirëpo, për njohësin e çështjeve ekonomike dhe gazetarin e

ekonomisë në "Top Channel", Klodian Tomori kjo nuk mund të ndodhë duke e shpjeguar edhe arsyen.

"Taksat e kalimit në rrugën Durrës-Kukës janë të përcaktuara qartë në kontratën koncesionare dhe variojnë nga 1 euro për përdoruesit e shpesh të deri në 22 euro për kamionët e rëndë me katër akse apo më shumë. Këto taksa nuk mund të ndryshohen nga askush. As të rriten, as të ulen, as të

shtohen në numër dhe as të pakësohen", ka thënë ai.

"Mënyra se si lëvizin mjetet e transportit në rrugë rregullohet përmes Kodit Rrugor. Në nenet 10, 54 dhe 62, Kodi përcakton qartë kufijtë e lejuar të peshave për transport në rrugë dhe sanksionet në ato thyhen. Sipas Kodit, pesha kufitare e përgjithshme me ngarkesë të plotë e një mjeti, që përbëhet nga pesha e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje dhe nga ajo e



ngarkesës së tij, nuk mund të jetë më e madhe se 5 tonë për aks për mjetet me një aks, 8 tonë për aks për ato me dy akse dhe 10 tonë për aks për ato me tre e më shumë akse. Çdo mjet që thyen këta kufi-

jtë ngarkesë shkel ligjin dhe është kërcënim për sigurinë rrugore. Kur shkel ligjin nuk taksohesh, por dënohesh sipas sanksioneve që parashikon ligji", ka thënë Tomori.

DnV-ja kërkon nga subjektet politike barazi gjinore në listat për deputetë

Drejtesi i koalicionit të OJQ-ve për vëzhgimin e zgjedhjeve "Demokracia në Veprim (DnV)", njëherësh drejtor i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, u ka bërë thirrje subjekteve politike që të garantojnë barazi gjinore në listat zgjedhore. Ai ka thënë se pjesëmarrja e barabartë e grave në politikë është ndër elementet kyçe të demokracisë e cila mundëson zhvillim të shoqërisë. Sipas Kryeziut, garantimi i barazisë gjinore në listat për deputetë kontribuon për një qeverisje më të mirë dhe demokratike

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 29 GUSHT - Koalicioni i OJQ-ve për vëzhgimin e zgjedhjeve "Demokracia në Veprim (DnV)" të enjten ka filluar përgatitjet për monitorimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 6 tetorit. Në një konferencë për medie drejtuesi i DnV-së, njëherësh drejtor i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, u ka bërë thirrje subjekteve politike që të garantojnë barazi gjinore në lista zgjedhore. Ai ka vlerësuar se pjesëmarrja e barabartë e grave në politikë është një ndër elementet kyçe të demokracisë e cila mundëson zhvillim juridik dhe social të shoqërisë. "Afati i rëndësishëm në procesin e organizimit të zgjedhjeve është afati për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre. Përgjatë këtij afati subjektet politike kanë mundësinë që përfundimisht ta garantojnë zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore duke aplikuar kuotën gjinore 50 për qind në listat e tyre zgjedhore dhe të sillen konform parimeve bazë të demokracisë. Pjesëmarrja e barabartë e grave në politikë është një ndër elementet kyçe të demokracisë e cila mundëson zhvillim juridik dhe social të shoqërisë. Kuota gjinore prej 30 përqindësh për listat e kandidatëve ka rezultuar në përfaqësimin më të madh të grave, pa pasur nevojë për kuotë gjinore", ka deklaruar ai.

Kryeziu ka thënë se garantimi i barazisë gjinore në lista zgjedhore, përveç që siguron respektimin e të drejtave fundamentale, kontribuon për një qeverisje më të mirë dhe demokratike. "Gjegjësisht, në legjislaturën e pestë, 20 nga 39 gratë deputete nuk kishin nevojë për kuotë për t'u zgjedhur. Në legjislatura e VI-të nga 38 deputete, 17 prej tyre kanë hyrë në Kuvend në saje të kuotës, kurse 21 prej tyre kishin fituar ulëse pa kuotë. Po ashtu, në legjislaturën e fundit shtatë nga 14 komisionet parlamentare janë udhëhequr nga deputetet. Andaj garantimi i barazisë gjinore në lista zgjedhore, përveç që siguron respektimin e të drejtave fundamentale, kontribuon për një qeverisje më të mirë dhe demokratike", ka theksuar Kryeziu. Ai ka treguar se DnV-ja do t'i vëzhgojë nga afër edhe aktivitetet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), duke konfirmuar angazhimin e saj për të siguruar një organizim dhe menaxhim të mirëfilltë të procesit zgjedhor. Sipas kryeziut, çështja e parë e cila kërkon vëmendje të menjëhershme nga subjektet politike është nominimi i anëtarëve të Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ), duke respektuar parimin e barazisë gjinore. "Të dhënat nga zgjedhjet e kaluara parlamentare tregojnë se partitë politike kanë nominuar vetëm 25 gra (ose rreth 9 për qind) nga 263 anëtarë të KKZ-ve, në mbi 40 për qind e komunave nuk kanë pasur



asnjë grua në përbërje të KKZ-ve, ndërsa vetëm katër nga 38 KKZ janë udhëhequr nga gratë. DnV u bënë thirrje subjekteve politike që premtimet e tyre për përfshirje të grave në proces zgjedhor mund të arrihen vetëm me veprime konkrete, duke garantuar përfaqësim të barabartë gjinor gjatë nominimit të anëtarëve të KKZ-ve, proces ky që ka filluar sot dhe përfundon me 31 gusht dhe që bazohet në Ligjin për Barazi Gjinore dhe në Kushtetutën e vendit", është shprehur ai, duke shtuar se për më tepër në vitin 2015 subjektet politike në vend kanë nënshkruar deklaratën për rritjen e përfshirjes së grave në proceset zgjedhore, e cila synonte rritjen e përfaqësimit të grave në trupat menaxhuese të zgjedhjeve që nga niveli qendror, në nivel komunal dhe në nivel të vendvotimeve, prej të paktën 40 për qind dhe deri në arrijtjen e përfaqësimit të barabartë për të dy gjinitë. Më tutje, Kryeziu u ka bërë thirrje qytetarëve të kontribuojnë në pastrimin e listës së votuesve duke i paraqitur tek organet përgjegjëse personat e vdekur. "KQZ-ja ka përcaktuar edhe periudhën e shërbimit të

votuesve dhe atë të kundërshtimit dhe konfirmimit të listës së votuesve, të cilat do të fillojnë më 3 shtator dhe përfundojnë më 14 shtator, respektivisht prej 12 deri më 14 shtator. Këto afate u mundësojnë qytetarëve t'i evidentojnë personat e vdekur të cilët figurojnë në listën e votuesve dhe të njëjtët t'i paraqesin tek institucionet përgjegjëse. DnV u bënë thirrje të gjithë qytetarëve që të shfrytëzojnë këtë afat kohor sepse kjo do të ndikonte në pastrimin e Listave të Votuesve dhe parandalimin e keqpërdorimeve eventuale", ka thënë ai. Kryeziu ka theksuar se shprehja e vullnetit qytetar të lirë në proceset zgjedhore duhet të jetë qëllim parësor i KQZ-së dhe subjekteve politike. Prandaj DnV-ja kërkon nga KQZ-ja dhe subjektet politike që t'i kushtojnë rëndësi dhe fokus të veçantë informimit dhe edukimit të votuesve. "Kjo sidomos duke marrë parasysh numrin e madh të fletëvotimeve të pavlefshme në ciklet e kaluara zgjedhore, e që ka derivuar kryesisht si rezultat i kampanjave joadekuate për edukimin e votuesve lidhur me mënyrën e votimit. Vetëm në zgjedhjet parla-

mentare të vitit 2017 janë evidencuar mbi 70 000 fletëvotime të pavlefshme, prej të cilave në 48.26 për qind të rasteve janë shënjuar vetëm kandidatët, por nuk është shënjuar subjekti politik, tregues ky për mungesën e informimit adekuat lidhur me mënyrën e votimit, si dhe problemeve me dizajnin e fletëvotimit. Lidhur me këtë, kërkojmë nga KQZ-ja t'i marrë parasysh rekomandimet e organizatave të shoqërisë civile lidhur me përmirësimin e kampanjave për informimin dhe edukimin e votuesve, si dhe ta përdorë dizajnin e fletëvotimit të propozuar nga shoqëria civile, i cili është përgatitur nga ekspertë të fushës, është testuar në publik dhe i njëjti i është prezantuar KQZ-së, bashkë me rezultatet e testimit, qysh në vitin e kaluar", ka deklaruar Kryeziu. Meqë DnV-ja do t'i përcjellë nga afër të gjitha proceset që ndërlidhen me organizimin dhe menaxhimin e zgjedhjeve, Kryeziu u ka bërë thirrje të gjithë aktorëve të përfshirë në proces, ta garantojnë organizimin e mirëfilltë të zgjedhjeve, duke aplikuar standardet demokratike dhe duke respektuar ligjet në fuqi.

Doktori nga Klina i bashkohet Nismës Socialdemokrate



PRISHTINË, 29 GUSHT (ER) - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka bërë me dije se trendit të ardhjeve në këtë subjekt politik të enjten iu bashkua edhe doktori nga Klina, Agim Krasniqi. "Prof. Dr. Krasniqi ka përfunduar specializimin dhe doktoraturën në Bukuresht, ku edhe ka punuar për shumë vjet. Që 12 vjet është

kthyer dhe punon në Kosovë. Ne kemi nevojë shumë për ekspertizën e çmuar të doktorit. Me doktorin do të jemi më të fuqishëm në Klinë dhe Kosovë. Nisma Socialdemokrate është mundësi e mirë për të gjithë profesionistët shëndetësorë, që së bashku të angazhohemi fuqishëm për t'i jetësuar politikën tonashëndetësore,

që në fokus kanë shëndetin e qytetarëve të Kosovës", ka thënë Limaj pas këtij aderimi. Ai ka theksuar se ardhjet e reja në Nismën Socialdemokrate janë dëshmia më e mirë se ky subjekt politik është në rrugë të drejtë pasi, sipas tij, personalitete të fushave të ndryshme po zgjedhin Nismën për ta dhënë kontributin e tyre.

Flet për "Epokën e re", Zafir Berisha

Koalicioni Nisma - AKR do t

Anëtari i Kryesisë i Nismës Socialdemokrate, Zafir Berisha, është shprehur i bindur se koalicioni Nisma - AKR do të jetë befasia e këndshme e zgjedhjeve të 6 tetorit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky koalicion është mirëpritur nga elektorati dhe ka mobilizuar strukturat partiake. Sipas Berishës, edhe më të pranueshëm këtë koalicion për qytetarët e ka bërë kandidatura e Fatmir Limajt për kryeministër. Ish-deputeti i Nismës ka bërë me dije se nuk do të ketë qeveri të re pa këtë subjekt politik



EPOKA E RE **Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 29 GUSHT - Ish-deputeti i Nismës Socialdemokrate, Zafir Berisha, ka bërë me dije se lidhja e koalicionit parazgjedhor Nisma - AKR ka formuar një bosht të ri politik i cili ka krijuar një shpresë të re për qytetarët e Kosovës. Ai ka deklaruar se ky koalicion do të jetë befasia e këndshme e zgjedhjeve të 6 tetorit.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Berisha ka treguar se përkrahja që po

gëzon te qytetarët po e bën këtë koalicion serioz për zgjedhjet e parakohshme parlamentare. "Ne jemi të bindur se do të jemi befasia më e këndshme e këtyre zgjedhjeve. Po ashtu, jemi të sigurt se pa Nismën nuk do të ketë qeveri, kurse sa i përket të parit, aty do të vendosë sovranin më 6 tetor, kur do të mbahen zgjedhjet. Përkrahja e madhe e elektoratit dhe mobilizimi i strukturës së Nismës kanë bërë që ky koalicion të jetë subjekt serioz në zgjedhjet e 6 tetorit dhe të jetë ajo befasia e këndshme që e presin të gjithë", ka

thënë Berisha.

Ai ka vlerësuar se ky koalicion po pritët mirë nga elektorati i të dy subjekteve politike. Sipas Berishës, ky bashkim i subjekteve politike do të jetë një shpresë e re për qytetarët e vendit. "Mendoj se tashmë edhe qytetarët e kanë kuptuar se Nisma dhe partitë që po ofrohen me Nismën janë një bosht i ri politik, një shpresë e re për institucionet e Kosovës pas zgjedhjeve. Kjo edhe për faktin se lidhja e Nismës në të gjitha periudhat e rëndësishme për Kosovën ka qenë i vendosur

dhe i guximshëm në shërbim të qytetarëve", është shprehur ai. Berisha ka mohuar mundësinë që ky koalicion në çastet e fundit t'i bashkohet ndonjë subjekti tjetër të madh politik. Ai është shprehur i bindur se në KQZ do të regjistrohen si koalicion dhe kandidat i tyre për kryeministër do të jetë Fatmir Limaj. "Jo, në asnjë mënyrë. Këtë as në ëndërr nuk është duke e parë ndokush. Nisma tashmë është përcaktuar për këtë çështje. Natyrisht se gjatë këtyre 24 orëve të fundit mund të pritët që t'i bashkohet

Nismës ndonjë subjekt më i vogël politik. Përndryshe, ne të premten në orën 24:00 do të aplikojmë në KQZ me kandidatin tonë për kryeministër, z. Fatmir Limaj", ka deklaruar Berisha.

"Epoka e re": Z. Berisha, Nisma Socialdemokrate ka arritur koalicion parazgjedhor me AKR-në. Cili është qëndrimi juaj rreth këtij koalicioni?

Berisha: Mendoj se tashmë edhe qytetarët e kanë kuptuar se Nisma dhe partitë që po ofrohen me të janë një bosht i ri

të jetë befasia e zgjedhjeve

prej partive politike siç është AKR-ja.

"Epoka e re": *Pra, mendon se elektorati i këtyre dy subjekteve e ka mirëpritur lidhjen e këtij koalicioni?*

Berisha: Mund të flas me kompetencë se strukturat dhe mbështesnit e Nismës Socialdemokrate e kanë pritur jashtëzakonisht mirë këtë koalicion, sepse Nisma si subjekt që ekziston për një periudhë të shkurtër në skenën e Kosovës është parti e besueshme deri në atë shkallë sa që edhe subjektet e tjera po i besojnë dhe po i bashkohen. Kjo me të vërtetë është një simbolikë domethënëse për Nismën Socialdemokrate.

"Epoka e re": *Mirëpo i dimë kritikën që lidhshipi i Nismës ka pasur dikur ndaj lidhshiptit të AKR-së. A mund të ndikojnë këto tek elektorati?*

Berisha: Përplasje ka pasur me Mimozen e jo me Pacollin. Me Pacollin më pak. Tashmë përplasjet në mes të lidhshiptit të partive të ndryshme janë të njohura për skenën politike të Kosovës. Nuk mendoj se ato përplasje kanë qenë aq substanciale sa që Nisma e AKR-ja të kenë vija të kuqe. Pastaj, kjo ka ndodhur në njoh kohë kur fare nuk ka ekzistuar Nisma si subjekt politik. Dhe, siç dihet, përcaktimi politik i Nismës është se nuk ka vija të kuqe për asnjë subjekt politik i cili e dëshiron Kosovën në situatë më të mirë politike dhe ekonomike. Besoj se tashmë e kanë kuptuar të gjithë se Nisma është subjekt i këndshëm politik dhe i pranueshëm për të gjithë.

"Epoka e re": *Cila do të jetë oferta e këtij koalicioni për qytetarët? Me çfarë premtimi gjatë fushatës ky koalicion do ta kërkojë votën e elektoratit?*

Berisha: Besoj se oferta e Nismës me programin e saj është në përfundim e sipër. Kjo ofertë do të jetë shumë e pranueshme për qytetarët e Kosovës, por më e pranueshme do të jetë kandidatura e z. Limaj si kryeministër i ardhshëm i Kosovës. Limaj deri më tani është dëshmuar për guxim dhe vendosmëri në shërbim të Kosovës dhe interesave të qytetarëve të saj.

"Epoka e re": *Nga pesë pretendentët për kryeministër, z Limaj i ka gjasat më të vogla për ta marrë atë post. Cilat janë pritjet tuaja për këto zgjedhje?*

Berisha: Jemi të bindur se do të

jemi befasia më e këndshme e këtyre zgjedhjeve. Po ashtu, jemi të sigurt se pa Nismën nuk do të ketë qeveri, kurse sa iu përket partive, aty do të vendosë sovranin më 6 tetor, kur do të mbahen zgjedhjet. Përkrahja e madhe e elektoratit dhe mobilizimi i strukturës së Nismës kanë bërë që ky koalicion të jetë subjekt serioz në zgjedhjet e 6 tetorit dhe të jetë

ajo befasia e këndshme që e presin të gjithë.

"Epoka e re": *Afati i fundit për regjistrimin e subjekteve politike dhe koalicioneve në KQZ është të premtën në mesnatë. A mund të presin që në minutat e fundit ky koalicion t'i bashkohet PDK-së apo ndonjë subjekti tjetër politik?*

Berisha: Jo, në asnjë mënyrë.

Këtë as në ëndërr nuk është duke e parë kush. Nisma tashmë është përcaktuar për këtë çështje. Natyrisht se gjatë këtyre 24 orëve të fundit mund të pritët që t'i bashkohet Nismës ndonjë subjekt më i vogël politik. Përndryshe, të premtën në orën 24:00 do të aplikojmë në KQZ me kandidatin tonë për kryeministër, z. Fatmir Limaj.

Kosnetti viziton KQZ-në, njoftohet për përgatitjen e zgjedhjeve

PRISHTINË, 29 GUSHT (ER) - Ambasadori amerikan Philip Kosnett ka vizituar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ku është pritur në takim nga kryetarja Valdete Daka dhe anëtarët e këtij institucioni. Daka ka vlerësuar vizitën e diplomatit amerikan në këtë fazë të rëndësishme të angazhimit të KQZ-së. Me këtë rast, ambasadori Kosnett ka shprehur mbështetje për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës të cilat do të mbahen më 6 tetor. "Z. Kosnett në mesazhin e tij vuri theksin në rolin thelbësor

të KQZ-së për proceset demokratike në Republikën e Kosovës si dhe përgëzoi KQZ-në për punën e deritanishme, duke e inkurajuar për të vazhduar në këtë drejtim", është thënë në njoftimin e KQZ-së. Sipas këtij njoftimi, ambasadori Kosnett ka bashkëbiseduar me anëtarët e KQZ-së lidhur me procesin zgjedhor të cilët e falënderuan ambasadorin amerikan për vizitën dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për përkrahjen e vazhdueshme ndaj Republikës së Kosovës në përgjithësi dhe KQZ-së në veçanti. Anëtarët e KQZ-së kanë shprehur përkushtimin e për-

bashkët për të punuar për përmbushjen e detyrave kushtetuese dhe ligjore për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme. Ambasadori amerikan Philip Kosnett të enjten është takuar edhe me kryeministrin në detyrë Ramush Haradinaj, me të cilin ka biseduar rreth zhvillimeve të fundit politike, me theks të veçantë zgjedhjet dhe maturinë politike që Kosova ka treguar deri më tani. Haradinaj në këtë takim ka theksuar se bashkërisht, të gjitha partitë duhet të jenë të përkushtuara për një proces zgjedhor fer dhe demokratik, si dhe për ta fuqizuar besimin e qytetarëve në institucione.



politik, një shpresë e re për institucionet e Kosovës pas zgjedhjeve. Kjo edhe për faktin se lidhshipi i Nismës në të gjitha periudhat e rëndësishme për Kosovën ka qenë i vendosur dhe i guximshëm në shërbim të qytetarëve. E them këtë sepse institucionet që pritët të dalin nga zgjedhjet e 6 tetorit janë institucione që kanë për të vendosur përfundimisht fatin e Kosovës në raport me temat që janë të hapura me armikun shekullor të Kosovës, Serbinë. Besoj se këtë e kanë kuptuar edhe qytetarët, por edhe disa

A do të fillojë me kohë viti i ri shkollor?

PRISHTINË, 29 GUSHT - Autoritetet kompetente të arsimit në Kosovë thonë se janë krijuar kushtet që më 2 shtator të fillojë viti i ri shkollor 2019/2020.

Viti i fundit shkollor ishte karakterizuar me grevën më të gjatë të mbajtur në arsim, që solli si pasojë humbjen e 15 ditëve të rregullta të mësimit për nxënësit e nivelit fillor dhe të mesëm në gjithë Kosovën. Por, edhe më 2 shtator, pavarësisht prej deklaratave të qeverisë, përkatësisht Ministrisë së Arsimit, se mësimi do të fillojë pa ndonjë shqetësim të veçantë, Shkencë dhe Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës ka paralajmëruar reagim nëse nuk zgjidhet problemi i mbylljes së disa shkollave në Komunën e Kamenicës.

Për shkak të këtij problemi, në këtë komunë mësimi mund të mos fillojë më 2 shtator, por nëse autoritetet përgjegjëse nuk gjejnë zgjidhje, sipas kryetarit të Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, Rrahman Jashari, mund të vihet në pikëpyetje mbarëvajtja e mësimit në gjithë Kosovën.

Jashari në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" thotë se nëse plani i Komunës së Kamenicës zbatohet për mbylljen e shkollës, greva do të përshkallëzohet në gjithë territorin e vendit. Ai thotë se si pasojë e këtij vendimi të Komunës së Kamenicës shumë mësimdhënës mund të mbesin pa punë. "Mësimdhënësit e Kamenicës do të fillojnë me grevë të përshkallëzuar, pastaj në ditën e dytë (3 shtator) do të ketë grevë dy orë, për t'i dhënë një javë kohë kryetarit të Kamenicës (Qëndron Kastrati) që bashkë me institucionet e tjera të mendojnë dhe ta tërheqin

vendimin për mbylljen e shkollave, në emër të një reforme, siç po e quan ai", ka thënë Jashari.

Nëse Komuna e Kamenicës nuk e tërheq vendimin për mbylljen e këtyre shkollave, theksoi Jashari, atëherë SBASHK-u do të solidarizohet me mësimdhënësit e kësaj komune, duke shtrirë grevën në nivel të Kosovës.

Por, pavarësisht prej paralajmërimeve të SBASHK-ut, kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka thënë se reforma në arsim do të fillojë gradualisht të zbatohet nga 2 shtatori.

Në një prononcim për "Radion e Evropa e Lirë", Kastrati thotë se në këtë komunë veprojnë 17 shkolla fillore dhe të mesme me 12 paralele, kurse reformat do të zbatohen në 10 shkolla. Po ashtu, ai ka thënë se riorganizimi i shkollave po bëhet për arsye se ka numër të vogël të nxënësve në disa prej tyre çka, sipas tij, ndikon edhe në cilësinë e arsimit. "Edhe kurrikula edhe ligji e rregullon se sa nxënës duhet të jenë në një klasë për të pasur një edukim cilësor, kurse ne jemi në gjendje të rëndë. Nëse e shohim gjendjen, i kemi 25 klasë me vetëm nga një nxënës, 19 klasë të tjera kanë vetëm nga 2 nxënës. Më shumë se gjysma e shkollave në klasat e para që kanë përfunduar kanë më pak se 5 nxënës. Andaj, qëllimi ynë është që të kemi 20 nxënës në klasë dhe dy paralele për gjeneratë. Pra, qëllimi kryesor janë nxënësit", ka deklaruar Kastrati, duke shtuar se edhe mësimdhënësit e këtyre shkollave nuk do të mbesin pa punë.

Ky riorganizim po konsiderohet sfidë edhe për Ministrinë e



Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Alush Istogu, drejtor i Departamentit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se aktualisht janë në bisedime me zyrtarë të Komunës së Kamenicës, që të gjendet një zgjidhje, në mënyrë që të anashkalohej greva. "Faktikisht në ato institucione arsimore është një numër i vogël i nxënësve. Por, janë disa procedura ligjore për këtë çështje. Ne si ministri jemi duke përgatitur grupin punues

në nivel të Ministrisë së Arsimit së bashku me drejtorinë komunale të arsimit që ta përgatisim planifikimin 2020/21 se si do të jetë rrjetëzimi i shkollave duke u bazuar në parametrat dhe kriteret që dalin nga aktet nënligjore", ka thënë Istogu. Përveç këtij problemi që është paraqitur në Komunën e Kamenicës, përgatitjet e tjera për fillimin e vitit të ri shkollor kanë përfunduar, thotë Istogu, duke shtuar se viti i ri shkollor 2019/2020 do të fillojë të hënën më 2 shkurt.

Edhe gjatë këtij viti të gjitha tekstet mësimore do të jepen falas për nxënësit e shkollës fillore. Bashkë me fëmijët e tjerë, në bankat shkollore gjatë këtij viti do të ulen edhe fëmijët të cilët u kthyen nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak.

Prej 74 fëmijëve sa u kthyen me familjet e tyre në Kosovë në prill të këtij viti, 10 prej tyre i takojnë nivelit të kopshteve, 5 janë parashkollorë, 25 do ta vazhdojnë arsimin fillor dhe 34 nivelin e mesëm të ulët dhe të lartë të arsimit.

Pacolli: Mitrovica ka qenë dhe mbetet bastion i AKR-së

MITROVICË, 29 GUSHT (ER) - Presidenti i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, ka vizituar degën e kësaj partie në Mitrovicë, ku ka zhvilluar takim me koordinatorin e degës, Nusret Qubrelin dhe anëtarë të tjerë të shumtë.

Në takim u confirmua edhe një herë që Aleanca Kosova e Re, pavarësisht prej individëve, mbetet e fuqishme siç ka qenë që nga themelimi i saj në vitin 2006.

Para anëtarëve të shumtë të degës, lideri i Aleancës Kosova e Re, Behgjet Pacolli, shprehu falënderimin e tij për angazhimin dhe besimin që

qytetarët mitrovicas po i japin AKR-së dhe vizionit të tij për zhvillimin e vendit. "Dyert e AKR-së mbeten të hapura për të gjithë atë që ia duan të mirën asaj, për të gjithë ata që me sinqeritet duan të punojnë me ne që bashkë t'i kthejmë dinjitetin qytetit të Mitrovicës", ka deklaruar Pacolli.

Lideri i Aleancës Kosova e Re në fund të këtij takimi ka falënderuar të gjithë anëtarët dhe simpatizantët e AKR-së dhe i ka siguruar ata që ai do të jetë pranë tyre dhe kështu me përkrahjen e tyre dhe me një program zhvillimor koalicioni AKR-Nisma-PD do të dalë fitues në Mitrovicë.



Vetëm 4.7 për qind e serbëve në veri i besojnë Policisë së Kosovës

Për shumicën dërrmuese të qytetarëve, Policia e Kosovës (PK) perceptohet si një nga institucionet më të besueshme në Kosovë. Por, komuniteti serb i Kosovës vazhdon të ketë perceptime negative për policinë, pasi vetëm 4.7 për qind prej tij ka besim në Policinë e Kosovës. Ndërkaq, 54.1 për qind e të anketuarve serbë pohojnë se oficerët e policisë nga stacioni më i afërt policor janë të korruptuar

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 GUSHT - Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë ka publikuar raportin "Perceptimi i komunitetit serb kundrejt Policisë së Kosovës: mike apo armike?" Ky raport përmbledh gjendjen ekzistuese në lidhje me qëndrimin e komunitetit serb të

Kosovës kundrejt PK-së në komunat me shumicë serbe, duke u fokusuar në katër komunat veriore të Kosovës.

Raporti mbulon kontekstin e ngjarjeve dhe zhvillimeve kryesore dhe e paraqet perceptimin publik kundrejt PK-së si rezultat të tensioneve politike në veri dhe gjendjes së përgjithshme të frikës në mesin e popullatës. Përveç

kësaj, raporti analizon shqetësimet kryesore të sigurisë të komunitetit serb të Kosovës, si dhe ofron disa rekomandime për adresimin e shqetësimeve dhe sfidave të tilla nga këndvështrimi i komunitetit.

Ky raport mbështetet në hulumtimet e gjera të ekipit të QKSS-së në veri të Kosovës dhe në komuna kyçe me shumicë serbe në pjesën

tjetër të Kosovës. Sipas këtij raporti, komuniteti serb i Kosovës që jeton në jug të lumit Ibër filloi ta mbështesë konceptin e policimit nga këndvështrimi i komunitetit dhe si një instrument i shërbimit publik. Ndërsa në veri, deri në shpërbërjen e strukturave paralele të sigurisë, si rezultat i Marrëveshjes së Brukselit në vitin 2013, mbizotëronte trashëgimia e sistemit të mëparshëm të policimit të bazuar në militarizim dhe interesat e shtetit serb. "Kjo ka sjellë perceptime të përziera ndaj PK-së në katër komunat veriore. Edhe pse shumë prej anëtarëve serbë të PK-së vijnë nga ish-MUP-i i Serbisë, ngurrimi

kundrejt PK-së shpërfaqet jo vetëm për shkak të simbolikës që lidhet me uniformën e PK-së, por edhe për shkak të nivelit të kompetencës dhe besnikërinë ndaj interesit të komunitetit. Kjo ide është shprehur nga politikani i njohur serb në pjesën veriore të Kosovës, z. Oliver Ivanović, i cili kishte thënë se të njëjtët persona, të cilët vepronin me kompetencë në MUP-in e Serbisë, nuk po vepronin në të njëjtin nivel nën uniformën e Kosovës", thuhet në raportin e QKSS-së.

Për shumicën dërrmuese të qytetarëve, Policia e Kosovës (PK) perceptohet si një nga institucionet më të besueshme në Kosovë, por komuniteti serb i Kosovës vazhdon të ketë perceptime negative ndaj policisë, pasi vetëm 4.7 për qind prej tij ka besim në Policinë e Kosovës. Ndërkaq, 54.1 për qind e të anketuarve serbë pohojnë se oficerët e policisë nga stacioni më i afërt policor janë të korruptuar. Komuniteti serb i Kosovës është, gjithashtu, skeptik në lidhje me integritetin e PK-së.

Drejtorja Rajonale e PK-së në Mitrovicën e Veriut ka 125 oficerë policie, prej të cilëve 13 janë gra; stacioni policor i PK-së në Zubin Potok ka 61 oficerë policie, prej të cilëve 5 janë gra; stacioni policor i PK-së në Leposaviq ka 99 oficerë policie, prej të cilëve 14 janë gra; stacioni policor i PK-së në Zvečan ka 60 oficerë policie, prej të cilëve 5 janë gra; stacioni policor i PK-së në Graçanicë ka 42 oficerë policie, prej të cilëve 5 janë gra; stacioni policor i PK-së në Shtërpçë ka 61 oficerë policie, prej të cilëve 7 janë gra.



Nga 1 deri më 30 shtator fillon periudha e aplikimit për çmime të barnave

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 GUSHT - Komisioni për përcaktimin e çmimeve të produkteve mjekësore ka mbajtur takimin e radhës, me ç'rast edhe ka marrë disa vendime në funksion të zbatimit të plotë të Udhëzimit Administrativ 02/2019 për rregullimin dhe unifikimin e çmimeve të produkteve mjekësore në sektorin farmaceutik në vend. Ky udhëzim do t'i rregullojë çmimet e produkteve të cilat janë pjesë e furnizimeve për institucione publike shëndetësore, atyre të cilat do të jenë të rimbursuara nga ana e Fondit për Sigurime Shëndetësore dhe, në fund, por jo më pak e rëndësishme, për produktet mjekësore të cilat janë subjekt i përshkrimit mjekësor (recetës) në mënyrë që ta adresojmë në tërësi këtë problematikë të çmimeve të

produkteve mjekësore.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur ka miratuar Rregulloren e punës si dhe anëtarët e komisionit kanë nënshkruar Deklaratën mbi konfliktin e interesit. Sipas afateve të përcaktuara, në këtë fazë është aprovuar edhe plani i veprimit si dhe afatet për hapjen e periudhës së aplikimeve nga mbajtësit e autorizimit të marketingut për çmimet e produkteve mjekësore. Kjo periudhë është vendosur të jetë prej 1 deri më 30 shtator 2019, pas së cilës pastaj do të bëhet shqyrtimi dhe analiza e këtyre aplikacioneve sipas metodologjisë së përcaktuar në këtë udhëzim.

Formati i aplikacionit është shtojcë e Udhëzimit Administrativ dhe obligativ për t'iu përmbajtur duke e dorëzuar atë të plotësuar në arkiv të Ministrisë së Shëndetësisë për Divizionin e Farmacisë - Sekretarinë Teknike të Udhëzimit



02/2019. Gjithashtu, i njëjti aplikacion në formatin elektronik në Excel duhet të dorëzohet edhe në e-mail adresën e MSh-së.

Të dhënat lidhur me udhëzimin, aplikacionet, afatet dhe informata të tjera të rëndësishme rreth këtij procesi gjithashtu do të publikohen

në uebfaqen e Ministrisë së Shëndetësisë (msh-rks-gov.net) dhe do të jenë të qasshme për palët e interesuara.

Kosova, pjesëmarrëse në Kampionatin Botëror të Lëvrimit

PRISHTINË, 29 GUSHT (ER) - Republika e Kosovës do të marrë pjesë në edicionin e 66-të të Kampionatit Botëror të Lëvrimit në mesin e 27 shteteve pjesëmarrëse i cili këtë vit do të mbahet në Baudette, Minnesota të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, më 30 dhe 31 gusht.

Anëtarësimi i Kosovës në Organizatën Botërore të Lëvrimit, i bërë para nëntë vjetëve, ua ka krijuar mundësinë lëvrujesve koso-

varë që të konkurrojnë me shtetet më të mëdha të botës, të cilat kanë përvojë shumëvjeçare në këtë fushë.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, e cila mbështet përfaqësimin e lavërtarëve në këtë kampionat, tregon se pjesëmarrja e përfaqësueses kosovare në këtë kampionat, përveç epitetit garues, ka për qëllime edhe promovimin e fuqishëm të shtetit të Kosovës,

shkëmbimin e praktikave më të mira të lëvrimit, përmirësimin dhe shfrytëzimin racional të tokës, duke u bazuar në rregulloren e Organizatës Botërore të Lëvrimit dhe aplikimin e rregullave të Organizatës Botërore të Lëvrimit (WPO).

Bekim Hoxha, udhëheqës i delegacionit kosovar, njëherësh edhe anëtar i Bordit të Organizatës Botërore të Lëvrujesve (World Ploughing Organization - WPO),

tha se garuesit kosovarë gjatë viteve të kaluara kanë arritur të tregojnë rezultate pozitive në këtë disiplinë dhe kjo ka bërë që Kosova ta tërheqë vëmendjen e shumë medieve botërore që po mbulojnë këtë ngjarje. "Kampionati Botëror i lëvrimit ka një traditë 66-vjeçare, ku shumica e shteteve tregojnë shkathtësitë e tyre në fushën e lëvrimit. Në mesin e këtyre shteteve, tashmë edhe Kosova ka shtatë vjet që merr pjesë në këtë

kampionat, me ç'rast lavërtarët kosovarë kanë arritur të tregohen mjaft të suksesshëm", ka thënë Hoxha.

Në Kampionatin Botëror të Lëvrimit, për shkak të buxhetit të limituar, Kosova këtë herë përfaqësohet me një garues të vetëm i cili është Lulzim Shehu, në disiplinën me plug konvencional, i mbështetur nga trajneri Afrim Sharku, si dhe kryetari i Organizatës së Lëvrujesve të Kosovës, Alban Rama.




KRU Prishtina paralajmëron shkyçje të borxhlinjve nga 2 shtatori

PRISHTINË, 29 GUSHT (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" sh.a. nëpërmjet një komunikate për medie ka njoftuar konsumatorët në zonën e shërbimit në Prishtinë, Fushë-Kosovë, Obiliq, Lipjan, Drenas, Podujevë, Shtime dhe Graçanicë, se aksioni për shkyçjen individuale të konsumatorëve borxhlinj nga shërbimet e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit për shkak të mospagesave ndaj shërbimeve të ujit dhe kanalizimit do të fillojë me intensitet të lartë nga 2 shtatori. "Shkyçjet individuale për konsumatorët borxhlinj po fillojnë nga muaji shtator. Paralajmërojmë konsumatorët borxhlinj ndaj shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit se

kanë obligim ligjor që t'i paguajnë faturat dhe borxhin e akumuluar.

KRU 'Prishtina' sh. a. ka shtuar aktivitetet për arkëtimin e borxheve edhe përmes detyrimit (shkyçje individuale të shërbimit, padi gjyqësore, përbarues privatë etj.) dhe natyrisht kjo shkakton shpenzime shtesë për buxhetin tuaj familjar: (shkyçja dhe rikyçja e ujit 20 euro, shpenzimet e përbaruesit privat 18 për qind në vlerën totale të borxhit të akumuluar)", është thënë në këtë komunikatë.

KRU "Prishtina" ka bërë me dije se me shkyçje do të përballet secili konsumator që ka dy fatura e më shumë të papaguara ndaj shërbimeve të ujit si dhe të



gjithë ata konsumatorë që kanë hyrë në marrëveshje në mes të kreditorit - debitorit dhe nuk u janë përmbajtur marrëveshjes kontraktuale.

Borxhi total i konsumatorëve ndaj shërbimeve për ujë dhe kanalizim është mbi 40 milionë euro.

KRU "Prishtina" tregon se u ka ofruar bashkëpunim dhe mundësi të lehta të ndryshme për pagesa të shërbimeve si riprogramim për borxhe të akumuluar. "Paraprakisht falënderojmë të gjithë konsumatorët që paguajnë rregullisht faturat e ujit, njëkohësisht ftojme borxhlinjtë që urgjentisht t'i paguajnë detyrimet që kanë ndaj KRU 'Prishtina'", është theksuar në komunikatën për medie.

ARKEP-i ende s'ka pranuar aplikim formal për transferim të numeracionit të përdorur nga 'Z-Mobile'



Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) ka bërë me dije se deri më tani nuk ka pranuar ndonjë aplikim formal për ndarje, ndërprerje të përdorimit apo transferim të numeracionit të përdorur nga "Z mobile" ashtu siç parashihet në mënyrë ligjore për vendimmarrjen në lidhje me resurset e komunikimeve elektronike

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 29 GUSHT - Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) ka njoftuar se është duke vazhduar ta trajtojë me prioritet të lartë procesin e përmbylljes së raportit komercial ndërmjet operatorit të rrjetit të telekomunikimeve, Telekomit i Kosovës dhe operatorit virtual të rrjetit "Z Mobile", me fokus të

veçantë për sigurimin e shërbimeve për përdoruesit fundorë (konsumatorët), përkundër faktit se marrëveshja e Telekomit (ish-PTK) me Dardafon (Z mobile) ka qenë e natyrës komerciale apo private siç njihet nga shumica e rregullatorëve evropianë. "ARKEP, që nga njoftimi zyrtar nga Telekomit i Kosovës për ndërprerjen e këtij bashkëpunimi, ka marrë disa veprime rregullative me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve,

ndër të tjera, edhe duke kërkuar nga palët të përmbahen nga veprimet e njëanshme që do të mund ta dëmtonin konsumatorin. Në funksion të kësaj, për shkak të rëndësisë që ka kjo çështje, është trajtuar në pesë mbledhje të Bordit të ARKEP-it, nga data 26 korrik 2019. ARKEP-i ua bënte me dije konsumatorëve të shërbimeve dhe opinionit të gjerë se sa i përket çështjes së numeracionit në përdorim për telefoninë mobile në Republikën e Kosovës, Ligji për komunikimet elektronike dhe Rregullorja për Planin Kombëtar të Numeracionit e përcaktojnë qartë mënyrën e aplikimit dhe ndarjes për përdorim apo transferim të numeracionit nga ARKEP, për ndërmarrjet që operojnë në tregun e komunikimeve elektronike", është thënë në komunikatën e Bordit të ARKEP-it.

Po ashtu, ARKEP-i ka bërë me

dije se deri më tani nuk ka pranuar ndonjë aplikim formal për ndarje, ndërprerje të përdorimit apo transferim të numeracionit të përdorur nga "Z Mobile", ashtu siç parashihet për vendimmarrjen në lidhje me resurset e komunikimeve elektronike me Ligjin dhe Rregulloren e lartpërmendur. "Njëkohësisht, në këtë rast ARKEP-i vë në pah se nuk bëhet fjalë për mungesë të numeracionit të cilin operatorët, përfshirë edhe Telekomit e Kosovës, e kanë në dispozicion. "Ata kanë kapacitete shumë më të mëdha sesa numri i klientëve të tyre dhe mund të marrin edhe numeracion shtesë në rast të paraqitjes së nevojës, në çdo kohë. Por, në secilin rast, është në diskrecion të përdoruesve fundorë që të vendosin se shërbimet e cilitdo operator do t'i marrin në shfrytëzim, megjithatë ARKEP-i do t'i ndër marrë të gjitha veprimet e

nevojshme që qytetarët të mund t'i mbajnë numrat e tyre, duke ua mundësuar vijueshmërinë e shërbimit, i cili në këtë rast është dhënë nëpërmjet rrjetit të operatorit Telekomit i Kosovës", është theksuar në komunikatën e ARKEP-it.

ARKEP-i ka njoftuar se ka pranuar informacionin nga Telekomit i Kosovës, se faza e tranzicionit për përmbyllje të këtij procesi do të zgjasë 120 ditë nga data 30 korrik. "U bëjmë me dije konsumatorëve dhe opinionit të gjerë, se ARKEP-i është i vendosur në përkushtimin e vet për zbatimin e Kushtetutës, ligjit dhe akteve të tjera rregullative sa i përket zhvillimit të veprimtarisë dhe zbatimit të kompetencave në fushën e vet. Prandaj, në asnjë rast nuk do t'u nënshtrohet interesave të kujtdo qoftë, e as paragjyqimeve të pabaza", është theksuar në komunikatën e ARKEP-it.

ATK-së i shtohen 20 inspektorë të rinj

PRISHTINË, 29 GUSHT (ER) - Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) i janë bashkuar 20 inspektorë tatimorë, të cilët të enjten kanë zyrtarizuar pozitën e tyre duke nënshkruar kontratat e punës. Me këtë rast, drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, u ka uruar mirëseardhje

inspektorëve të rinj, duke kërkuar nga ta që ta japin kontributin e tyre në realizimin e misionit të ATK-së, me theks të veçantë trajtimin korrekt dhe të njëtrajtshëm të tatimpaguesve. Murtezaj ka potencuar se procesi i rekrutimit ka qenë një proces i drejtë dhe transparent, ku përzgjedhja e kandidatëve

është bërë në bazë të kriterëve të parashtruara me konkurs. "ATK-ja në vazhdimësi ka pasur një numër jo të mjaftueshme të inspektorëve tatimorë, për t'i mbuluar të gjitha aktivitetet e planifikuara, andaj këta inspektorë do të jenë vlerë shtesë për arritjen e objektivave", ka thënë Murtezaj.



Shkollat e Deçanit janë gati për fillimin e vitit të ri shkollor

DEÇAN, 29 GUSHT (ER) - "Të gjitha shkollat në Komunën e Deçanit të jenë të gatshme t'i hapin dyert për nxënësit më 2 shtator", ka thënë drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA), Bekim Vishaj.

Vishaj ka treguar se edhe gjatë pushimeve verore në vazhdimësi kanë punuar me drejtorët e shkollave, stafin teknik dhe të tjerët për përgatitjet e fillimit të vitit të ri shkollor. Ai ka

thënë se shkollat janë pajisur me material higjienik, furnizim me dru, pajisje me material zyrtar dhe administrativ, pastrim dhe lyrje të brendshme në disa shkolla.

Vishaj ka thënë se kanë pranuar edhe tekstet shkollore për filloristë, libra të cilat kanë filluar të barten në shkollat përkatëse dhe të pajisen nxënësit sapo të nisë vitin e ri shkollor. Drejtori i DKA-së, Bekim Vishaj, ka bërë

me dije se gjatë këtij pushimi kanë vazhduar trajnimet e mësimdhënësve për kurrikulën e re. "Gjatë verës janë respektuar afatet ligjore për rekrutimin e punëtorëve të ri në sistemin arsimor, si DKA jemi pothuajse në përmblyje të procesit të konkurseve. Vlen të theksohet se investimet nga MASHT-i dhe komuna në disa shkolla do të vazhdojnë pa penguar procesin mësimor", ka thënë Vishaj.



Protestojnë kompanitë e funeraleve, akuzojnë BIK-un për monopol

PRISHTINË, 29 GUSHT - Komunës së Prishtinës të enjten ia kanë zënë derën disa makina të kompanive funerale. Këto kompani nëpërmjet këtij veprimi kanë shprehur pakënaqësitë për një marrëveshje të cilën janë duke e konsideruar joligjore në mes të Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), Komunës së Prishtinës dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI).

Kompanitë në fjalë nëpërmjet një proteste simbolike e kanë akuzuar BIK-un për monopol në kryerjen e shërbimeve të funeraleve, shitjen e arkivoleve dhe dërrasave të ndryshme.

Përfaqësuesi i kompanive funerale, Blerim Nreci, në një

konferencë për medie para objektit të Komunës së Prishtinës ka renditur vendimet që, sipas tij, janë joligjore nga ana e BIK-it. "I lutemi Komunës së Prishtinës të na japë sqarim në lidhje me marrëveshjen me BIK-un që e ka bërë para dy vjetëve se ku ka qenë favorizimi i BIK-it, apo komunës. Komuna ia ka dhënë një mundësi Bashkësisë Islame të zhvillojë biznes brendapërbrenda saj dhe të krijojë shitje të arkivoleve, dërrasave, qefinëve dhe shërbimeve të tjera funerale. Kërkoj nga komuna të ndërmarrë menjëherë ndonjë veprim që t'i ndalë. Ne si kompani nuk kemi të drejtë t'u ofrojmë qytetarëve me numër fiskal, edhe pse jemi të



licencuar prej Ministrisë së Tregtisë. Kurse Bashkësia Islame me një dëftesë që ne më herët i merrnim në biblioteka, me atë dëftesë rimbursohet qytetari. Të hyrat brenda Bashkësisë Islame brenda një muaji sillen 35 mijë euro. Kemi punuar shtatë kompani, tash nuk punojmë asnjë. Vetëm automjete kanë mbetur rreth 100 mijë euro, kurse Bashkësia Islame punon vetëm me një kamion", ka thënë ai. Gjithë këtë veprim të BIK-it, Nreci e konsideroi si punon ilegale, jashtë rregullores dhe statutit të tyre. Ai, po ashtu, e ka akuzuar BIK-un se ka lokale ilegale në një lagje të Prishtinës ku shet arkivole.

Komuna e Vushtrrisë nis ndërtimin e shtatë shesheve në fshatra



VUSHTRRI, 29 GUSHT (ER) - Nëpërmjet një ceremonie, të enjten në fshatin Stanoc i Ulët i Komunës së Vushtrrisë ka nisur ndërtimi i sheshit të fshatit, i cili do të ketë terrene sportive dhe hapësira publike të qëndrimit. Në ceremoninë e fillimit të punimeve ka marrë pjesë kryetari i Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, i cili ua ka shpjeguar banorëve në detaje projektin e sheshit. "Qëllimi i këtij projekti është krijimi i hapësirave publike në shtatë fshatra më të mëdha të Komunës së

Vushtrrisë, për të vazhduar më pas edhe në fshatra të tjerë, ku do të ndërtohen parqe me fusha sportive, vende për ulëse për pleqtë me tabela shahu, me tabela pingpongu, me parkingje, gjelbërim e ndriçim që besoj se kanë për ta ndryshuar jetën e qytetarëve nëpër fshatra", ka thënë Tahiri.

Ai ka theksuar se është duke u vazhduar krijimi i shesheve edhe nëpër fshatra, fillimisht në shtatë fshatra, më pas do të vazhdohet në të gjitha fshatrat e Vushtrrisë.

Komuna e Ferizajt angazhohet për mbrojtje të pyjeve nga prerja ilegale


FERIZAJ, 29 GUSHT (ER) - Mbrojtja e pyjeve nga dëmtuesit në territorin e Ferizajt tashmë po merr dimension të ri, më efektiv dhe me shtrirje më të gjerë si rrjedhojë e zbatimit të obligimeve në mes Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pyltarisë në Ferizaj dhe Policisë së Kosovës, Stacionit Policor në Ferizaj me njësitet e tij dhe me mbështetjen nga Njësia e Reagimit të Shpejtë në kuadër të Strategjisë

Nacionale të Mbrojtjes së Ambientit dhe Planit Operativ "Mbrojtja e Pyjeve 2019". Për këtë në malet e Jezercit, Policia e Kosovës, në patrullimet e befasishme, ka kapur në flagrancë disa prej prerësve ilegalë të pyjeve, me ç'rast ka arrestuar këta të fundit duke i proceduar para organeve të drejtësisë. Drejtimit të këtij operacioni të gjerë i ka paraprirë formimi i grupeve të përbashkëta në mes

të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pyltarisë së Kosovës, si dhe Policisë së Kosovës, me ç'rast ka rezultuar me paraqitjen e qindra rasteve të prerjes ilegale të pyjeve në territorin e Ferizajt. Ky aksion do të vijojë deri në reduktimin drastik të këtij fenomeni shkatërrimtar me pasoja të parikuperueshme për mjedisin, për çka janë mobilizuar edhe aktorët kryesorë të kësaj fushe.



DEKORIMI I URREJTËSIT RACIST



Rexhep QOSJA

"Në një moment historik, kur kral Petri, më 1913, në Deçan, e ndezi atë qiriun e madh të dylltë, të cilin, siç na mëson kujtimorja, mbretëresha Milica e la për t'iu dhuruar atij që do të hakmerret për Kosovën, serbët naivisht besuan se robërisë shëkullore i erdhi fundi, se u plotësua fati ynë dhe se rilindi mbretëria e car Dushanit. Të verbuar nga shkëlqimi i armëve tona, ata nuk kuptuan se shqiptarët e islamizuar, të rehatuar në trojet serbe, janë turq më të tmerrshëm se turqit. Duke mos pasur në çka të mbështeten, ata nuk u zhvilluan lartësueshëm, por u zgjeruan rrafshueshëm, të bindur se zgjerimi i tillë, i bërë me bindjen se të kujt janë dhentë e tij është edhe bjeshka, u jep të drejtë që t'i përvetësojnë tokat tona. Harruan mendjelehtët se ky "ligj natyror" nuk zbatohet në shoqërinë e qytetëruar. Kështu një popull pakëz i njohur, pjesëtarët e të cilit kishin bisht maceje ose qeni, dhie ose kali, dhe s'e dallonin sheqerin prej borës, siç i përshkruanin dikur hulumtuesit dhe shkencëtarët gjermanë, mbasi u dëbuan turqit, "doli prej pyllit" dhe u paraqit në

skenen politike botërore. Dhe, fuqitë e mëdha evropiane, duke pasur parasysh punët dhe interesat e veta, këtij populli "bishtak" i ndihmuan që ta krijojë shtetin e vet.

Por, shqiptarët nuk ishin të kënaqur me këtë shtet, prandaj edhe nuk hoqën dorë prej programit kombëtar, prej projektit të quajtur "Shqipëria e Madhe", që përfshin edhe një pjesë të madhe të hapësirës etnike serbe - gjithë vatrën tonë kosovare.

Në këtë mënyrë ky rrëfim i njohur historik u dramatizua. Dhe u ndez zjarri mes dy popujve, zjarr që, kur më i vogël e kur më i madh, po qiste flakë përgjatë një shekulli...

Para dy dhjetëvjetëshave ky zjarr mori flakë aq të madhe sa që ne u rrezikuar të digjemi në të.

Gjysma e botës iu turr Serbisë dhe në tokën tonë të shenjtë me luftë u krijua edhe një gjysmështet shqiptar.

Të bijtë e atyre shqiptarëve të vjetër, që s'kanë ardhur prej pyllit ballkanik, por prej parapyllit evropian, nuk janë të pajisur ndoshta me bisht shtaze, por me disa veçanti shtazarake...

Këta djegin e rrënojnë kisha e manastire, gropojnë zemra e u nxjerrin sy njerëzve të gjallë. Këta jo njerëz, kufomavjedhës, i prishin varret dhe vatrën tona, i asgjësojnë rrënjët tona me qëllim që të shuajnë dhe kujtesën tonë. Këtë strategji kombëtare raciste, shqiptarët, me pajtimin e mentorëve të tyre, pa kurrfarë pengesash po e realizojnë para syve të krejt botës.

Parashteti s'do të bëhet shtet.

Serbia mund të jetë e shkelur, por kurrë e mundur, thotë (thoshte) Gavrillo Principi...

Mua më lartëson Kryqi i artë i knjazit të lavdishëm, që ma dhuroat, kurse ju po përkuleni nën Kryqin e rëndë të Shpëtimtarit, në të cilin dushmanët duan t'u shqyejnë. Ju jeni vëllezërit e betimit, në ju qëndron mbretëria. Le t'ju ndihmojë i Madhi Zot!"

Ky tekst është fjalim i mbajtur në oborin e Kishës së Graçanicës me rastin e dhënies së Çmimit "Kryqi i artë i knjaz Lllazarit", që jepet çdo vit në përkujtim të Vidovdanit - të disfatës serbe në Kosovë në vitin 1389.

Këto në të vërtetë janë disa fragmente të atij fjalimi që më 27 qershor të këtij viti i tha në oborin e lulëzuar të Kishës mesjetare të Graçanicës, afër, shumë afër Prishtinës, poeti i shumëçmuar dhe shumë herë i dekoruar në Serbi, Gojko Gjogo.

Që e tha Gojko Gjogo këtë fjalim me përmbajtje nacionaliste, raciste, shoviniste kundërshqiptare, që e tregojnë fragmentet që po ua paraqes këtu lexuesve shqiptarë, nuk është gjë e çuditshme: fjalimet, shkrimet, deklaratat, veprat letrare, veprat historike, veprat publicistike e përmbajtje të tillë, me politikë e ideologji të tillë, raciste, shoviniste, fyese ndaj shqiptarëve kanë një traditë më tepër se 150 vjeçare në jetën e në kulturën serbe. E çuditshme është se këtë fjalim ai e tha në Graçanicë, në Kishën e lavdishme të Graçanicës! E çuditshme është që këtë fjalim e tha Gojko Gjogo në Graçanicë ku, krahas disa institu-

cioneve shtetërore serbe të Serbisë, funksionojnë edhe disa institucione shtetërore të Kosovës!

Dhe, më tej, e çuditshme është se këtë fjalim Gojko Gjogo e mbajti më 27 qershor, dy ditë para tubimit të një numri të dukshëm serbësh te monumenti i Trimave serbë në Gazimestan dhe e mbajti si parafjalë të fjalëve politike, nacionaliste, që do të dëgjohej në atë tubim, me të cilin u shënua 630 vjetori i ngritjes serbe në nivelin e popullit qiellor pas disfatës së knjaz Lllazarit në ballafaqimin luftarak me sulltan Muratin.

E shpreh çuditjen time pse fjalimi në fjalë u mbajt ku u mbajt dhe kur u mbajt dhe pse u mbajt jo pse me këtë çuditje do të shprehja kërkesën për ndalimin e atij fjalimi. Jo. Jo. Kam qenë, jam e do të jem gjithmonë kundër ndalimeve e kufizimeve të mendimit e të shprehje së lirë, qoftë edhe si ato të Gojko Gjokos në Graçanicë më 27.6.2019 dhe jo vetëm në Graçanicë, po edhe kudo tjetër, madje edhe në Qeverinë e Kosovës, pa qenë të ndëshkuara siç ndodhi në Qeverinë tonë ku për paraqitje ç'është e vërteta të padrejta mospajtuese me qëndrimet e Qeverisë së Kosovës u ndëshkuan me shkarkim prej kësaj qeverie dy ministra serbë! Por, shpreh çuditjen time me atë fjalim për një arsye tjetër: për arsye se Qeveria e Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Kryesia e Kosovës, me gjithë numrin gati kinez, gati rus, gati indian a brazilian të këshilltarëve e informuesve të tjerë të tyre, si duket,

s'morën vesh asgjë kur duhej për atë fjalim, nuk e lexuan kur duhej të lexohej megjithëse ai u botua në disa revista e gazeta serbe, megjithëse ai u pa e u lexua në disa ambasada në Prishtinë e shumë kund tjetër!

Dhe, e shpreh çuditjen time me atë fjalim që shpreh politikën dhe ideologjinë e djeshme e të sotme të Serbisë ndaj Kosovës, ndaj shqiptarëve, ndaj Shqipërisë pse institucionet shtetërore të Kosovës nuk e quajtën të nevojshme që t'i thonë kur duhej ndonjë këshilltari, shkrimtari, mercenari - akademik të Seksionit të Gjuhës e të Letërsisë të ASHAK-ut të tyre a ndonjë mercenari kryetar nga ata tre kryetarët e ASHAK-ut që qe 25 vjet e përdorin si shtëpi private atë ASHAK të shkretë, që ta shprehë mospajtimin e shtetit të Kosovës me përdorimin e Kishës së Graçanicës e të Komunës së Graçanicës si tribunë raciste, shoviniste dhe fyese ndaj Kombit shqiptar.

Por, por nuk kanë kohë për mospajtim të tillë as sundimtarët e as mercenarët e tyre. Janë të zënë me punë më të frytshme për veten e tyre e më të mjerueshme për vetë Kosovën!

Janë të zënë sundimtarët tanë dhe çerekademiçet e tyre të mercenarizuar me pajtimin që t'i dhurohen Malit të Zi disa mija hektarë tokë me rëndësi ekonomike e gjeostrategjike por, por jo edhe me mospajtimin me sovranitetin shtetëror serb të komunës së Graçanicës e të Kishës së Graçanicës në shtetin e Kosovës!

Gjendja e sigurisë në Lipjan vlerësohet e qetë

LIPJAN, 29 GUSHT (ER) - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Lipjanit ka mbajtur takimin e rregullt me radhë nën kryesimin e nënkryetarit të komunës, Fauz Xhemajli. Nënkryetari Xhemajli ka thënë se gjendja e sigurisë në Komunën e Lipjanit vlerësohet e qetë dhe stabile. Përveç pikave të tjera të rendit të ditës, KKSB-ja me theks të veçantë ka diskutuar për raportin për gjendjen e

sigurisë në territorin e Komunës së Lipjanit, të cilin e ka paraqitur komandanti i stacionit policor në Lipjan, Bashim Bytyqi, ku thuhet se gjendja e sigurisë në Komunën e Lipjanit është e qetë. Ndër të tjera, në këtë takim anëtarët e KKSB-së si prioritet të domosdoshëm theksuan parandalimin e dukurive negative në gjithë territorin e Komunës së Lipjanit, ku u kërkua angazhim dhe bashkëpunim më i madh i qytetarëve me policinë.



Conte merr mandatin nga presidenti për formimin e qeverisë

ROME, 29 GUSHT - Presidenti italian, Sergio Mattarella ngarkoi të enjten kryeministrin në detyrë, Giuseppe Conte për formimin e një qeverie të re e cila do të mundësojë daljen nga kriza pa kaluar në zgjedhje të parakohshme. Zgjidhja erdhi pas konsultimeve të një dite më parë mes Lëvizjes 5 Yjet dhe Partisë Demokratike. "I transmetuar presidentit se kishim pranuar propozimin e L5Y (Lëvizja 5 Yjet) për emrin e

presidentit të Këshillit të Ministrave", theksoi sekretari i PD Nicola Zingaretti, në përfundim të konsultimeve. "Ne gjithashtu konfirmuan me vendosmëri nevojën për të ndër-tuar një qeverisje të përparuar dhe të pandërprerë", shtoi ai. "Le të jetë e qartë se nuk ka stafetë për të vazhduar dhe nuk ka dëshmitarë për të mbledhur, por përkundrazi një sfidë e re për të filluar. Qeveria e re do të sjellë fillimin e një sezoni të ri, civil,

shoqëror dhe politik", tha Zingaretti. Lëvizja e Salvinit krijoi paqëndrueshmëri politike që e ktheu edhe një herë vëmendjen e investitorëve në Itali, duke rritur kostot e huamarjes në borxhin e saj që vazhdon të mbetet i lartë. Italia gjithashtu përballlet me një afat kritik në vjeshtë për hartimin e një buxheti për Bashkimin Evropian, me mundësinë e ngritjes së taksës së vlerës së shtuar për t'i mbuluar mangësitë.



Zemërim në Britani pasi Johnson detyroi pezullimin e Parlamentit

Vendimi i kryeministrit britanik, Boris Johnson, për të pezulluar punën e Parlamentit nxiti protesta në Londër, Mançester, Edinburg dhe qytete të tjera, dhe shkaktoi reagime të ashpra nga deputetët dhe kundërshtarët e Brexit-it pa marrëveshje

LONDËR, 29 GUSHT - Vendimi i kryeministrit britanik, Boris Johnson, për të pezulluar punën e Parlamentit nxiti reagime të ashpra nga deputetët dhe kundërshtarët e Brexit-it pa marrëveshje. Ai po ashtu shkaktoi protesta në gjithë Britaninë dhe një peticion me më shumë se një milion nënshkrime. Mbretëresha Elizabeta II, të mërkurën, e miratoi zyrtarisht kërkesën e Johnsonit për të pezulluar punën e Parlamentit para Brexit-it, apo largimit të Britanisë nga Bashkimi Evropian. Brexit-i pritet të ndodhë më 31 tetor dhe pezullimi i punës së Parlamentit do të zvogëlojë dukshëm kohën e ligjvënësve për të diskutuar largimin nga blloku. Johnson do që Brexit-i të ndodhë më 31 tetor, me ose pa marrëveshje me BE-në, edhe pse institucionet financiare e kanë paralajmëruar Britaninë për pasojat të rënda ekonomike nëse e lë bllokun pa marrëveshje mbi kushtet e divorcit. Kryetari i Parlamentit britanik, Jacob Rees-Mogg, tha se kundërshtarët e kryeministrit nuk janë të

sinqertë dhe "thjesht duan të qëndrojnë në BE". Jeremy Corbyn, udhëheqës i Partisë Laburiste në opozitë, tha se pezullimi i punës së Parlamentit është "një goditje e fortë kundër demokracisë" dhe përsëriti se mund të thërrasë një votim mosbesimi ndaj Qeverisë së Johnsonit, ka njoftuar rfe. Mijëra njerëz protestuan në Londër, Mançester, Edinburg dhe qytete të tjera, ndërsa një peticion në internet që e dënon vendimin për Parlamentin mbledhi më shumë se 1.1 milion nënshkrime deri në mëngjesin e së enjtes. Derisa Johnson këmbënguli se Parlamenti do të ketë mundësi për të debatuar mbi programin e përgjithshëm të qeverisë dhe qasjen ndaj Brexit-it, udhëheqësja e Demokratëve Liberalë në opozitë, Jo Swinson, i tha BBC-së se kryeministri "është i gatshëm t'i heshtë zërat e njerëzve përmes përfaqësuesve të tyre në Parlament". Ish-kancelari Philip Hammond u zotua se do të vazhdojë të luftojë kundër Brexit-it pa marrëveshje, ndërsa vendimin e Johnsonit për



të pezulluar punën e Parlamentit e cilësoi si "thelësisht jodemokratik". Ministria e Parë e Skocisë, Nicola Sturgeon, tha se Johnsoni po vepron si "diktator", duke bërë "një sulm të egër mbi parimet themelore demokratike". Data për Brexit është shtyrë dy herë. Parlamenti britanik e ka refuzuar tri herë marrëveshjen për dalje, e cila është arritur vitin e kaluar midis Brukselit dhe qeverisë së paraardhëses së Johnsonit, Theresa May.

BE-ja ka thënë se nuk do të ketë rinegociim të marrëveshjes. Me vendimin e së mërkurës, puna e Parlamentit do të pezullohet jo më herët se 9 shtatori dhe jo më vonë se 12 shtatori. Vendimi i dominoi artikujt e gazetave të enjten. "Times" tha se Johnsoni "e ka shtyrë Britaninë në prag të një krize kushtetuese", ndërsa "Guardian" parashikoi një "përplasje historike parlamentare" pasi kundërshtarët kërkojnë të parandalojnë një Brexit pa marrëveshje. "Financial Times", në një shkrim

editorial, tha se pezullimi i punës së Parlamentit "është një sulm ndaj demokracisë". Presidenti amerikan, Donald Trump, në një postim në Twitter shprehu mbështetjen e tij për Johnsonin, duke thënë se "do të jetë shumë e vështirë" për Corbynin që të kërkojë një votë mosbesimi kundër kryeministrit, marrë parasysh se Boris është pikërisht ai që Mbretëria e Bashkuar e ka kërkuar. Britania ka vendosur të dalë nga BE-ja përmes një referendumi në vitin 2016.

ShBA-ja do të mbajë praninë në Afganistan edhe pas marrëveshjes së paqes

UASHINGTON, 29 GUSHT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, tha se ShBA-ja do të vazhdojë të mbajë prezencën e saj ushtarake në Afganistan, edhe pasi të arrihet një marrëveshje paqesje me talibanët. Duke folur në një intervistë në radio Fox News më 29 gusht, Trumpi tha se numri i trupave do të bjerë në rreth 8.600.

"Ne do të mbajmë një prani atje", tha Trumpi. Zyrtarët amerikanë dhe talibanët aktualisht janë përfshirë në një rund të nëntë bisedimesh, për të nënshkruar një marrëveshje historike, që do t'i jepte fund konfliktit 18-vjeçar afgan. ShBA-ja po kërkon që talibanët të japin garanci, se vendi nuk do të shndërrohet në fole të grupeve terroriste, pas tërheqjes së trupave të huaja.

ShBA-ja synon që fillimisht të arrihet kjo marrëveshje, dhe më pas të fillojë dialogu i brendshëm afgan, i cili do të siguronte paqen afatgjatë për vendin. Tash për tash, talibanët që kontrollojnë një pjesë të madhe të Afganistanit, nuk po pranojnë të bisedojnë me Qeverinë afgane, pasi e cilësojnë atë si "kukull të Perëndimit".





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E rrallë

Zbulohet portreti i paraardhësit tonë që jetoi 3.8 milionë vite më parë



Fytyra jashtëzakonisht e plotë, që i përket një paraardhësi të hershëm njerëzor që jetoi 3.8 milionë vjet më parë, është zbuluar në Etiopi. Paraardhësi i përket specieve njerëzore Australopithecus

anamensis dhe ngjason me majmunin. Shkencëtarët e kanë quajtur një ikonë të evolucionit njerëzor. Kafka pritet të hedhë dritë mbi historinë e evolucionit të paraardhësve të njeriut.

FOTO E DITES



Dy panda shihen duke ngrënë bambu në një kopsht zoologjik në Francë /AP/

E jashtëzakonshme

"Lufta" me domate, mijëra persona marrin pjesë në festën tradicionale



Mijëra njerëz morën pjesë në luftën tradicionale të domates në qytetin Bunyol, Spanjë, duke i hedhur njëri-tjetrit domate.

Organizatorët e festimit thanë se u hodhën 145 ton domate mbi të pranishmit, duke e shndërruar qytetin në një det me ngjyrë rozë

dhe të kuqe. Disa mbanin syze mbrojtëse dhe disa ndërtesa ishin të veshura me pëlhurë për të mbrojtur muret e tyre.

BARSOLETA E DITËS



Djali: Babë a na godet neve kjo kriza financiare?
Baba: Jo, i godet ata që kanë para?
Djali: Po neve?
Baba: Neve na sos na qetë përtokë!




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30 The Angry Birds Movie 2 (3D)

Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 39 min
 Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj, etj.

Regjia: Thurop Van Orman



Në ora 17:30

GOOD BOYS

Aventurë/Komedi; 1 orë 29 min

Rolet: Jacob Tremblay, Keith L. Williams, Brady Noon, Molly Gordon, Lil Rel Howery, Will Forte, etj.

Regjia: Gene Stupnitsky




Çdo ditë në ora 19:15

"HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.
 Regjia: David Leitch




Çdo natë në ora 21:30 ONCE UPON A TIME IN HOLLYWOOD

Komedi/Dramë; 2 orë 41 min

Rolet: Leonardo DiCaprio, Brad Pitt, Margot Robbie, Al Pacino, etj.

Regjia: Quentin Tarantino



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Sot doni të ndryshoni rrugën që keni marrë për të tejkaluar një problem të caktuar. Duhet të merrni dhe mendimin e të tjerëve.</p>	 <p>DEMI Keni kuptuar që jeta është e përbërë edhe nga gjëra të tjera përveç punës dhe po i dedikoheni këtyre gjërave tërësisht sot.</p>	 <p>BINJAKËT Iniciativat që do të ndërmerri sot do t'ju japin shumë zgjidhje personave afër jush. Dikush do t'ju shprehë falënderimet në një mënyrë të ngrohtë.</p>	 <p>GAFORRJA Një problem konstant që nuk po ju lë të avanconi duhet ta zgjidhni nga rrënjët sepse do të vazhdojë t'ju torturojë për një kohë të gjatë.</p>	 <p>LUANI Sot keni vënë në dukje një anë të panjohur tuajën dhe mjaft të ndjeshme. Jeni kokëfortë në shumicën e rasteve dhe nuk i tregoni ndjenjat tuaja.</p>	 <p>VIRGJERESHA Dikush do të kërkojë sqarime nga ju se përse gjatë kësaj kohe nuk keni shfaqur përkushtimin e duhur.</p>
 <p>PESHORJA Këtë periudhë keni zgjedhur një mënyrë kontradiktore për të qenë në vëmendje, vetëm nëpërmjet heshtjes tuaj dhe injorimit të personave të caktuar.</p>	 <p>AKREPI Keni bërë ç'është e mundur për të sqaruar gjërat me një person të caktuar por përsëri ju kanë keqkuptuar.</p>	 <p>SHIGJETARI Sot mund t'ju lindin probleme me familjarët sepse nga punët e tepërta do të harroni disa ngjarje dhe situata që nuk mund të harrohen.</p>	 <p>BRICJAPI I keni dhënë hapësirën e duhur personave të duhur por nuk jeni shprehur për këtë gjë. Do të keni mirënjohjen e tyre në të ardhmen e afërt.</p>	 <p>UJORI Të ecni përpara në karrierën tuaj në këto momente paraqitet mjaft e vështirë. Ka rrethana të caktuara që nuk ju lejojnë të bëni atë që doni.</p>	 <p>PESHQIT Kritikat e bëra ndaj jush po japin rezultate pozitive në punën tuaj sepse keni marrë më të mirën prej tyre dhe e keni vënë në zbatim.</p>

Gigi Hadid e mbështet miken e saj Serena Williams gjatë lojës



Modelja e njohur, Gigi Hadid, të mërkurën ka shikuar lojën e mikes së saj, Serena Williams. Hadid teksa qëndronte në New York's Flushing Meadows ishte e entuziazmuar për

lojën e mikes së saj, pasi kishte reagime interesante të cilat morën vëmendjen e të gjithëve. Hadid ndjehej e lumtur por edhe e dëshpëruar me disa raste gjatë lojës së tenisit.

Brad Pitt e provon sërish me Jennifer Aniston?



Ubënë gjashtë muaj që prej ndarjes së çiftit të famshëm Brad Pitt dhe Angelina Jolie. Por, duket se Brad Pitt i ka kthyer sërish sytë nga ish e dashur e tij Jennifer Aniston. Sipas një burimi para disa ditësh, Pitt i ka çuar një mesazh urimi Anistonit në ditëlindjen e saj të

48-të. Komunikimi i tyre interaktiv ka vazhduar edhe më tej, duke kujtuar edhe momente nga e kaluara e tyre si çift, shkruan "Bordo". "Brad i ka folur Jenniferit për kohën e vështirë që po kalon pas ndarjes dhe ajo i ka dhënë mbështetjen e saj", është shprehur një burim.




Dua kundër kryeministrit britanik

Këngëtarja me prejardhje nga Kosova, Dua Lipa, ka dalë kundër kryeministrit britanik, Boris Johnson. Ai ka vendosur ta shpërndajë parlamentin

në prag të Brex-it dhe kjo gjë nuk i ka pëlqyer aspak Duas. Këngëtarja ka publikuar në rrjetet sociale një fotografi të Johnsonit si shkatërruesi i demokracisë në vend.

Robert Smith dhuron kitarën e tij si donacion për bamirësi

Këngëtari i njohur i muzikës rock, Robert Smith, më 31 gusht do të jap donacion kitarën e tij të performimit në festivalin Pasadena Daydream. Sipas "Daily Mail" të ardhurat nga kjo kitarë do të shkojnë për bamirësi të ndryshme të artit për fëmijë duke përfshirë Little Kids Rock dhe Fondacioni i Holland Opus. Robert ka vendosur të dhurojë një kitare të re me nënshkrimin e Schecter Robert Smith UltraCure, e cila u ridizajnuar së fundmi për vitin 2019.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Dukagjini dhe Drita kërcënojnë njëra-tjetrën me humbje

Dukagjini dhe Drita synojnë fitore në ndeshjen e parë të javës së tretë në IPKO Superligë. Altin Merlaku i ka dërguar porosi skuadrës nga Gjilani, se në Klinë do të pësojë humbje, në anën tjetër edhe Bujar Shabani paralajmëron se gjilanasit kërkojnë tri pikët e plota në stadiumin "18 Qershori"



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 GUSHT - Altin Merlaku e ka paralajmëruar skuadrën e Dritës se do të rikthehet nga Klina duarbosh, pasi fitorja në ndeshjen që zhvillohet sot (e premte) do t'i takojë Dukagjinit. Skuadra e promovuar këtë edicion në Superligën e futbollit, Dukagjini, në ndeshjen e parë si vendës barazoi me Ballkanin (0-0), kurse ndeshja e javës së dytë ndaj Prishtinës është shtyrë për datën 25 shtator. "Ne jemi munduar të përgatitemi mirë për ndeshjen ndaj Dritës dhe jemi të bindur në fitore. Përkrahja si në ndeshjen e parë nuk do të mungojë as në këtë ndeshje dhe besoj se shikuesit do të kënaqen me atë që do të ofrojmë në fushë, por edhe me fitore. Kundërshtari ka ekip të mirë, por pikët mbesin në Klinë", ka thënë Merlaku për

"Epokën e re". Ndërsa edhe ish-kampionia e Kosovës në futboll, Drita, është e përgatitur maksimalisht për ta shënuar fitoren e dytë radhazi në IPKO Superligë ndaj Dukagjinit. Skuadra nga Gjilani në javën e kaluar e mposhti Flamurtarin (3-0), kurse sot (e premte) synon ta bëjë të njëjtën gjë edhe në ndeshjen që zhvillohet në stadiumin "18 Qershori" në Klinë. Këtë synim të ish-kampionëve e ka bërë me dije "Epokën e re", Bujar Shabani. "Ne jemi në një moment të mirë dhe vijmë pas fitores bindëse ndaj Flamurtarit. Shpresoj se edhe ndaj Dukagjinit do të kemi paraqitje të mirë dhe t'i marrim pikët e plota, për çka jemi përgatitur gjatë gjithë javës", ka thënë Shabani, i cili më pas ka treguar edhe për lojtarin më të mirë në skuadrën kundërshtare. "Nuk kam shumë njohuri për lojën që aplikon Dukagjini, por e di se

di se e kanë një ekip të mirë me një lojtar si Mark Milicaj, i cili është ndër më të mirët në Kosovë. Sivjet Drita e synon titullin dhe në çdo ndeshje luajmë për fitore", ka deklaruar Shabani. Tri ndeshje të tjera të kësaj xhiroje zhvillohen të shtunën, kurse dy ndeshjet e fundit të javës së tretë zhvillohen të dielën.

IPKO SUPERLIGA

Të premten takohen:
16:00 Dukagjini - Drita

Të shtunën takohen:
16:00 Feronikeli - Prishtina
16:00 Llapi - Ballkani
16:00 Flamurtari - Ferizaj

Të dielën takohen:
16:00 Trepça'89 - Drenica
16:00 Gjilani - Vushtrria

SHKURT

Fenerbahçe refuzon ofertën e majme për Muriqin

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, e ka nisur në mënyrën më të mirë aventurën në skuadrën e Fenerbahçes, duke shënuar dy gola në dy ndeshjet e para. Kjo ka bërë që në adresë të gjigantit turk të vijë një ofertë mjaft joshëse nga Arabia Saudite për sulmuesin nga Kosova. Mediet turke raportojnë se Fenerbahçe ka refuzuar ofertën që ishte 12 milionë euro. Muriqi në të kaluarën ka qenë pjesë e Lirisë së Prizrenit dhe Teutës së Durrësit.

Franca, me 6 mungesa ndaj Shqipërisë

Shqipëria do të përballet me Francën në takimin e parë të muajit shtator, për eliminatorët e vlefshme për "Euro 2020". Në listën e kampionëve të botës vërehet mungesa e 6 futbollistëve shumë të rëndësishëm. Bëhet fjalë për Lacazette, Martial, Dembele, Kante, Mbappe dhe Umtiti.

Basha pensionohet nga Kombëtarja e Shqipërisë

Mesfushori nga Kosova, Migjen Basha, ka konfirmuar pensionimin nga Kombëtarja e Shqipërisë. Lajmin për pensionim e ka konfirmuar mesfushori nga Suhareka, i cili thotë se ka ardhur koha për t'iu përkushtuar më tepër familjes së tij. "Mendoj se ka ardhur koha e duhur për mua që t'i dedikoj më tepër kohë familjes sime. Por, në të njëjtën kohë, t'ua japim mundësinë edhe lojtarëve më të rinj të kenë më tepër hapësira në ekipin kombëtar", ka shkruar Basha në "Facebook". "Dua t'i falënderoj nga zemra të gjithë lojtarët e ekipit kombëtar, shokët e miqtë e mi gjatë këtyre viteve. Falënderoj stafin teknik të ekipit kombëtar dhe Federatën Shqiptare të Futbollit për mundësinë!", ka shtuar Basha.

Elma Kameri transferohet në Belgjikë

ISTOG, 29 GUSHT - Hendbollistja më e mirë e Kosovës, Elma Kameri, është transferuar në Superligën e Belgjikës te skuadra "DHW United Antwerpen". "KHF Istogu, bordi udhëheqës, bashkëlojtarët dhe stafi i trajnerëve dhe adhuruesit e klubit e falënderojnë Elma Kamerin për gjithë kontributin e dhënë për klubin

tonë dhe ajo është një ndër më meritoret për të gjitha të arriturat e Istogut. Ne jemi krenarë që për shumë vite pjesë e Istogut ka qenë hendbollistja më e mirë në vend, ku së bashku ndërtoam një skuadër model", thuhet në njoftimin e KHF Istogu. Elma Kameri është reprezentuese e rregullt e Kosovës, kurse me Istogut ka

fituar dy herë rresht Kupën e Kosovës, titullin e kampionit, kurse ishte pjesë e 16 skuadrave më të mira në Evropë në kupën Challenge Cup. Ndërsa është shpallur golashënuesja më e mirë në Kosovë, tri herë beku i majtë më i mirë i Kosovës dhe dy herë rresht hendbollistja më e mirë e Kosovës.



Kosova, e 12-ta në 'Patra 2019'

PRISHTINË, 29 GUSHT - Ekipi i meshkujve në Beach Volley ka mbyllur të enjten garat në Lojërat Mesdhetare në Rërë "Patra 2019". Ekipi i Kosovës në përbërje: Faton Mustafa e Armend Berisha, të prirë nga

trajneri Bahri Gjinovci, pësuan humbje sot nga Greqia 2:0 në sete (21:11 dhe 21:16), në ndeshjen që vlente për kualifikim në çerekfinale. Kosova e mbyll garimin në Beach Volley me arritje në

top 12-she, pas fitores që shënoi sot ndaj Andorrës 2:0. Të mërkurën edhe vajzat mbyllën garat, duke pësuar dy humbje nga kundërshtarët e forta si Sllovenia dhe Franca, me të cilët bënë

paraqitje të mirë dhe deri diku ishin rivale të barabarta. Ekipi i vajzave u përbë nga dyshja: Valmire Ramadani e Dhuratë Sylejmani, me trajneren Vildane Jashari.



Krasniqi: Jam i zhgënjyer që nuk dola i treti në 'Patra 2019'

PRISHTINË, 29 GUSHT - Notari Arti Krasniqi për pak nuk arriti ta fitojë medaljen e bronzit në Lojërat Mesdhetare në Rërë "Patra 2019". Notari Krasniqi doli i katërti në disiplinën pesë kilometra në ujëra të hapura, nga 16 garues pjesëmarrës. Koha e tij ishte 59 minuta e 49.10 sekonda, vetëm 22 sekonda më shumë sesa medalisti i bronzit, greku Georgios Arniakos. Dy vendet e para iu takuan italianëve: Andrea Manzi (57.57.20) dhe Marcello Guidi (57.57.8). "Kam dhënë maksimumin dhe normalisht se jam pak i zhgënjyer që nuk dola i treti, por edhe kjo pozitë është shumë e mirë për mua. Jam i kënaqur me paraqitjen. Gara nuk ishte e lehtë për shkak të valëve që mbretëronin", ka deklaruar Arti Krasniqi për "nokokosovo.org". Gara e Krasniqit u ndjek nga drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës dhe atë të Federatës së Notit të Kosovës, të cilët, po ashtu, mbetën të kënaqur me paraqitjen e shkëlqyeshme të



Artit, i cili dëshmoi se ka cilësi dhe të ardhme të ndritur. Arti ditë më parë vendosi ta lë Gjermaninë për ta përfaqësuar Kosovën.

Shtohen garat në Formula 1



Londër, 29 gusht - Në botërorin e vitit 2020 do të zhvillohen 22 gara në sportin e Formulës 1, një rekord. Federata Ndërkombëtare e Automobilizmit (FIA) ka publikuar kalendarin provizor të garave të vitit 2020 dhe në të figurojnë 22 gara. Mes tyre edhe dy pista të reja: Në Holandë dhe Vietnam, ndërkohe që nga kalendari i vitit tjetër është hequr gara e Gjermanisë.

Botërori 2020 do të nisë më 15 mars në Australi dhe do të përfundojë më 29 nëntor në Abu Dhabi, raporton "Telesport". Ky shtim i garave i ka çuar në 7 javët dyshe, ku garohet çdo fundjavë, pa një javë pushim. Pistat e kombinuara për fundjavat dyshe janë: Australi-Bahrein; Holandë-Spanjë; Azerbajxhan-Kanada; Francë-Austri; Belgjikë-Itali; Singapor-

Rusi dhe Amerikë-Meksikë. Drejtuesit e Formulës 1 shpresojnë se ky shtim i garave të jetë vetëm hapi i parë, pasi objektivi i tyre është të arrihet kuota e 24 pistave. Këtë sezon numri i garave është 21. Për momentin, kalendari i vitit 2020 është provizor dhe tani u takon skuadrave ta japin mendimin e tyre deri në tetor për propozimet e bëra.

SHKURT

Arrihet marrëveshja për rikthimin e Neymarit në Barcelonë

Neymari do të jetë lojtar i ri i Barcelonës. "Sky Sport Italia" raporton se marrëveshja në mes të Paris Saint-Germainit dhe Barcelonës për rikthimin e yllit brazilian në "Camp Nou" është arritur. Barça për 27-vjeçarin do të pagujë një shumë të lartë parash dhe ka ofruar shërbimet e Jean-Clair Todibo dhe Ivan Rakitiqin, derisa ende nuk është vendosur për Ousmane Dembelen. Neymarit ishte larguar nga Barcelona dy vjet më parë për shifrën rekord prej 222 milionë eurosh.

Valencia në garë për Hysajn

Mbrojtësi i Kombëtares Shqiptare, Elseid Hysaj, është vetëm një hap larg transferimit në kampionatin spanjoll. Mediat italiane raportojnë se interesim për mbrojtësin shkodran ka shfaqur skuadra e Valencias. Edhe menaxheri i Hysajt, Mario Giuffredi, pranoi se po negociohet mes palëve dhe se po nxitohet që të arrihet një marrëveshje brenda kësaj jave, pasi dihet se afati kalimtar mbyllet më 2 shtator. Paraprakisht thuhet se Valencia është ofruar ta marrë Hysajn në huazim me të drejtë blerjeje për 18 milionë euro, por edhe formula e transferimit është ende duke u negociuar mes klubeve.

Biraghi rikthehet tek Interi



Interi nuk po ndalet në këtë afat kalimtar, pasi e ka transferuar edhe Cristiano Biraghin. Në fakt, Interi e mori Biraghin në formë huazimi nga Fiorentina dhe me të drejtën e blerjes së përhershme në fund të sezonit. Biraghi është futbollist i dalë nga të rinjtë e Interit, por ka bërë karrierë edhe në Pescara, Granada, Chievi dhe Catania.

Szczesny: Në garë për titull është edhe Interi

Vitet e fundit ka qenë skuadra e Juventusit që dominoi në futbollin italian dhe konkurenti i vetëm ishte Napoli. Portieri i "Zonjës së Vjetër", Tomasz Szczesny, parashikon një kampionat më interesant për faktin se në garë për titull sivjet do të jetë edhe Interi. "Në vitet e fundit rivali ynë i vetëm ka qenë Napoli, prandaj ne presim me padurim të përballemi me të të shtunën në mbremje. Gjithsesi, sivjet edhe Interi është forcuar, ndaj gara pritet të jetë edhe më e bukur sesa në vitet e kaluara", ka thënë Szczesny.

Botërori kinez 'pushtohet' nga NBA-ja

Të shtunën do të nisë Botërori i Basketbollit për Meshkuj, turne ku marrin pjesë 32 skuadrat më të mira. Ajo që bie në sy është se 56 basketbollistë që do të luajnë në këtë ngjarje, e cila do të zhvillohet në Kinë (31 gusht-15 shtator), aktivizohen në NBA. Përveç 12 lojtarëve të kombëtares amerikane, pothuajse çdo ekip që është kualifikuar në Botëror ka të paktën nga një lojtar. Janë 16 kombëtare të tjera pjesëmarrëse në botëror që kanë lojtarë që aktivizohen në skuadrat e NBA-së. Sipas statistikave, ekipi i NBA-së që ka më shumë lojtarë në Botëror është ai i Boston Celtics, me 6 përfaqësues. Më pas vjen Milwaukee Bucks me 5 lojtarë dhe

Republika e Kosovës
Rpublika Kosovo/ Republik of Kosovo
Komunal Dragash/ Opština Dragaš / Daragas Municipality

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12 par.1 pika 1.1 të ligjit nr.03/L-149 për Sherbimin Civil të Kosovës, neni 3 dhe 4 të Rreg. nr.02/2010 për proc. e rekrutimit në Sherbimin Civil dhe në bazë të kërkesës së Drejtorit për Ekonomi, Bugjet, Financa dhe Zhvillim Ekonomik K Dragash , të drejtuar në zyrën e shërbimit te personelit K Dragash nr.03.111/01-22965 për pranimin e një punëtori në këtë drejtori, zyra e Shërb. të Personelit pranë K Dragash publikon këtë ;

KONKURS
I brendëshem

Pozicioni; Zyrtar për Mbledhje të Detyrueshme BF/930
Niveli i pagës; grada 9 Koeficient 7
Periudha e kontratës; 1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi
Vendi i punës; Drejtoria për Ekonomi Bugjet Financa dhe Zhvillim Ekonomik
Orët e punës; 40 ore ne javë
Përgjegjës mbikëqyrës ; Drejtorit për Ekonomi Bugjet Financa dhe Zhvillim Ekonomik

Përshkrimi i punës dhe përgjegjësitë



- Kontrollon nëse element të ndryshëm të faturave të tatimit në pronë janë në përputhje me Ligjin;
- Identifikon faturat e tatimit në pronë që nuk duhet të lëshohet në bazë të paragrafit 7 të nenit 21 të Ligjit;
- Shtyp certifikatën e vlerës së vlerësuar;
- Kontrollon nëse pagesa e detyrimeve tatimore është bërë në kohë;
- Kërkon në kohë nga zyrat/drejtoritë e ndryshme brenda Komunës, pezullimin e shërbimeve komunale;
- Përgatit në kohë propozimin për përmbarim;
- Pezullon procedurat e mbledhjes së detyrueshme për rastet e parashikuara në paragrafin 4 të nenit 33 të Ligjit dhe njofton, nëse është e aplikueshme autoritetin përmbarues;
- Heton dhe bashkëpunon me të gjitha autoritetet publike, personat juridik ose organet që administrojnë ose kanë në dispozicionin e nevojshëm për pronën e debitorit (pasurinë/asetet);
- Aplikon, nëse është e nevojshme, metoda të vlerësimit të rrezikut, për të përcaktuar dhe zbatuar në çdo rast masat më të përshtatshme, për të maksimizuar mbledhjen e detyrimeve tatimore të paguara;
- Raporton në baza të rregullta mbi aktivitetet e mbledhjes në divizionin përkatës për inspektimin dhe mbledhjen e detyruar në Departamentin e Tatimit në Pronë;
- Përbush çdo përgjegjësi/detyrë tjetër të zyrarit/sekretorit të mbledhjes, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi të tatimit në pronë, apo të caktuar nga Menaxheri/Drejtori i Zyrës së Tatimit në Pronë.
- Dërgon/dorëzon njoftimet, fat. e tatimit në pronë, certifik. e vlerës së vlerësuar dhe aktet e tjera zyrtare.

Shkathësit kryesore të kërkuara

- Diplome universitare, drejtimi ekonomik, financa, biznes apo të ngjashme, 2 vite përvojë profesionale
- Njohuri dhe përvojë në fushën e tatimit në pronë, shkath. në komunikim planif. të punës dhe udhëheqje të ekipit
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomand. dhe këshillave
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të prog. (Word, Excel, Power Point, Internetit);
- Njohuri dhe përvojë në lemin e ekonomis; fleksibilitet ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës, përfshirë zgjidhjen e problemeve;

Afati i Konkursit; Konkursi mbetet i hapur 8 ditë, nga dita e shpalljes, kërkesat e parashtruara pas këti afati nuk do të pranohen. Aplikacionet për aplikim merren në zyrën e Shërbimit të Personelit nr.9 K.Dragash.

Sherbimi i Personelit

Republika e Kosovës
Rpublika Kosovo/ Republik of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opština Dragaš / Daragas Municipality

Na osnovu člana 11 i člana 12 par.1 tačka 1.1 Zakona br.03/L-149 o civilnoj službi Kosova, članova 3 i 4 Uredbe br.02/2010 o procedurama zaposljavaanja u državnoj službi i na osnovu zahteva Direktora za Ekonomiju, Budžet i Finansije O.Dragaš upućenom Kadrovskoj službi O.Dragaš br.03.111/01-22965 o zaposljavaanju jednog radnika u ovom direktorijatu, Kancelarija za kadrovsku službu u O.Dragaš objavljuje;

KONKURS
(Interni)

Pozicija; Službenik za obavezne naplate BF/930
Nivo plate; stepen 9, Koeficijentat 7
Period ugovora; 1 (jedan) godišnji sa mogućnošću produženja
Odsek; Direktorijat za Ekonomiju, Budžet, Finansije i Ekonomski Razvoj
Radno vreme; 40 sati nedeljno
Izveštava; Direktor za Ekonomiju, Budžet, Finansije i Ekonomski Razvoj

Opis posla i odgovornosti:

- Proverava da li su različiti elementi računa poreza na imovinu u skladu sa zakonom;
- Identifikuje račune za porez na imovinu koje ne bi trebalo da se izdaju u skladu sa stavom 7 člana 21 Zakona;
- Štampa potvrdu o procenjenoj vrednosti;
- Proverava da li se plaćanje poreskih obaveza vrši na vreme;
- Zahteva na vreme od različitih kancelarija / direktorijata unutar opštini obustavu opštinskih usluga;
- Priprema na vreme predlog za izvršenje;
- Obustavlja postupke obavezne naplate za slučajeve predviđene u stavu 4. člana 33. zakona i obaveštava, ako je primenljivo za izvršno telo;
- Istražuje i saraduje sa svim javnim organima, pravnim licima ili organima koji upravljaju ili imaju pristup imovini dužnika;
- Primenuje, ako je potrebno, metode procene rizika, da bih odredili i primenili u svakom slučaju najprikkladnije mere, kako bi se maksimizirala naplata neizmirenih poreskih obaveza;
- Redovno izveštava o aktivnostima naplate u odgovarajućem odeljenju za obavezu inspekciju i naplatu u odeljenju za porez na imovinu;
- Obavlja sve drugo obavezo / zadatke službenika / sekretara za naplatu, kako je definisano u važećem zakonodavstvu o porezu na imovinu, ili kako mu je dodelio menadžer / direktor kancelarije za porez na imovinu;
- Šalje / dostavlja obaveštjenja, račun poreza na imovinu, overava procenjene vrednosti i drugih zvaničnih akata.

Potrebne kvalifikacije i veštine:

- Diploma univerziteta, Ekonomski fakultet, finansije, poslovno ili slično, 2 godine profesionalno radno iskustvo.
- Znanje i iskustvo u oblasti poreza na imovinu, veštine u komunikaciji planiranje rada i rukovođenje timom.
- Spretnost u istrazi, analitiku, ocenivanje i formuliranje preporuka i saveta;
- Veštini za ispunjavanje zadataka i poslova pod pritiskom;
- Poznavanje rada na računaru i aplikacije (Word, Excel, Power Point, Internet);
- Znanje i iskustvo u oblasti ekonomije; Fleksibilnost u organizaciji i nadzoru rada, uključujući i rešavanje problema;

Rok konkursa: Konkurs ostaje otvoren 8 kalendarskih dana od dana objavljivanja, prijave podnete posle ovog roka neću biti primljene. Obrasci za prijavu mogu se dobiti u Kancelariji za kadrovske usluge br.9 O.Dragash.

Kadrovska služba

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Banesë me qira në Dardani për çif bashkëshortësh. Banesa ka 50 m2 me një dhomë gjumi, sallon e kuzhinë, banjo e ballkon dhe shpajz. Kati i 7 me lift. Çmimi 250 €uro kontakti 044-171328.

▶ Besarta Idriz Shatri shpallë të pavlefshme diplomën e Kolegjit AAB-Bachelor në Përkujdesje dhe Mirëqenie e Fëmijëve..

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përçjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irro 044/672-439.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

